FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al
www.qpz.gov.al

Nr.150 3 tetor 2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9989 datë 15.9.2008	Për disa ndryshime në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar ……	7375
Ligj nr.9990 datë 15.9.2008	Për një shtesë në ligjin nr.8097, datë 21.3.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar ……	7376
Ligj nr.9991 datë 18.9.2008	Për ratifikimin e Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) "Për shërbimet e punësimit, C 88, 1948" ……	7376
Ligj nr.9992 datë 18.9.2008	Për ratifikimin e Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) "Për politikën e punësimit, C 122, 1964" ……	7382
Ligj nr.9993 datë 18.9.2008	Për ratifikimin e kontratës së shitjes së 85 për qind të aksioneve të ARMO sh.a.-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe blerësit "AMRA OIL, sh.a." dhe konsorciumit "Refinery Associates of Texas, Anika Enterprises & Mercuria Energy Group" ……	7386
Ligj nr.9994 datë 18.9.2008	Për një ndryshim në ligjin nr.7875, datë 23.11.1994 "Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë", të ndryshuar ……	7387
Vendim i Kuvendit nr.213, datë 29.9.2008	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr.4, datë 19.9.2005 "Për zgjedhjen e byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit" ……	7388
Vendim i Kuvendit nr.214, datë 29.9.2008	Për shtyrjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Kodin Zgjedhor, ngritur me vendimin nr.192, datë 30.6.2008, të ndryshuar ……	7388

Vendim i KM nr 1269, datë 17.9.2008	Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore ……	7389
Vendim i KM nr.1272, datë 17.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë Universitetit të Tiranës, në vitin akademik 2008-2009 ……	7395
Vendim i KM nr.1273, datë 17.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në vitin akademik 2008-2009	7396
Vendim i KM nr.1274, datë 17.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, në vitin akademik 2008-2009	7397
Vendim i KM nr.1275, datë 24.9.2008	Për lejimin e kalimit transit të disa autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë……	7398
Vendim i KM nr.1276, datë 25.9.2008	Për lejimin e kalimit transit të disa autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë ……	7399
Vendim i KM nr.1287, datë 24.9.2008	Për hapjen, në qytetin e Lushnjës, të filialeve, përkatësisht, të Fakultetit të Ekonomisë e të Agrobiznesit dhe të Fakultetit të Bujqësisë e të Mjedisit, të Universitetit Bujqësor të Tiranës, dhe të programeve të studimit, të ciklit të parë, në këto filiale, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe, për vitin akademik 2008-2009 …	7400
Vendim i KM nr.1288, datë 24.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, pranë universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, në vitin akademik 2008-2009 ……	7401
Vendim i KM nr.1289, datë 24.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, pranë universitetit "Fan.S.Noli", Korçë, në vitin akademik 2008-2009 ……	7401
Vendim i KM nr.1290, datë 24.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, pranë universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, në vitin akademik 2008-2009	7402
Vendim i KM nr.1291, datë 24.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mesuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, pranë universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër, në vitin akademik 2008-2009 ……	7403
Vendim i GJL nr.3, datë 12.2.2008	Me objekt anulimin e aktit administrativ të detyrimit tatimor, në shumën e 95 506 lekë, të datës 7.7.2004 ……	7404
Kërkesë e MPPTT nr.3867/1, datë 4.9.2008	Për shpronësim për interes publik për pasuritë që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Kukës-Shishtavec……	7414
Kërkesë e MPPTT nr.4988/1, datë 2.9.2008	Për shpronësim për interes publik për pasuritë që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Kardhiq-Delvinë……	7416

LIGJ
Nr.9989, datë 15.9.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9385, DATË 4.5.2005 "PËR PYJET DHE SHËRBIMIN PYJOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 19 pika 1, paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

"Ministri miraton dhe shpall listën e vendeve ose të shesheve të fondit pyjor publik, ku mund të ushtrohen këto veprimtari, ndërsa për pyjet komunale, listën e shpallin njësitë e qeverisjes vendore.".

Neni 2

Në nenin 26, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Personat fizikë dhe juridikë mund ta trajtojnë dhe shfrytëzojnë fondin pyjor kombëtar vetëm kur kanë dalë fitues në procedurat e konkurrimit publik dhe kur lidhin kontratën me drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor ose me njësinë e qeverisjes vendore. Kërkesat, që duhet të plotësojnë subjektet për pjesëmarrje në konkurrimin publik, përcaktohen me udhëzim të ministrit. Të drejtat, që sigurohen nga kontrata për trajtimin dhe shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar, nuk mund t'u transferohen të tretëve. Subjektet, që kanë lidhur kontratën, mund të ndërtojnë ose të vendosin instalime të përkohshme, sipas skemave teknologjike, të miratuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor.".

Neni 3

Në nenin 27, pikat 5 e 7 ndryshohen si më poshtë:

"5. Kërkesat dhe rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore përcaktohen me udhëzim të ministrit.

7. Materiali drusor, i përpunuar ose i papërpunuar, si dhe prodhimet e tjera pyjore e jopyjore transportohen nga pikat e grumbullimit dhe qendrat e përpunimit deri në destinacionin përfundimtar, të shoqëruara me një vërtetim transporti, të lëshuar nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, nga njësitë e qeverisjes vendore ose nga pronari privat, ku vërtetohet prodhimi i tyre, në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Modeli i vërtetimit të transportit miratohet nga ministri.".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5897, datë 1.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

LIGJ
Nr.9990, datë 15.9.2008

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8097, DATË 21.3.1996 "PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8097, datë 21.3.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 1 pika 8 shkronja "b" shtohen fjalët "Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5898, datë 1.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

LIGJ
Nr.9991, datë 18.9.2008

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS (ILO) "PËR SHËRBIMET E PUNËSIMIT, C 88, 1948"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) "Për shërbimet e punësimit, C 88, 1948".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5899, datë 1.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTA E SHËRBIMIT TË PUNËSIMIT C88, 1948

Konventa për Organizatën e Shërbimit të Punësimit (Shënim.Data e hyrjes në fuqi: 10.8.1950)
Konventa: C88
Vendi: San Francisko
Sesioni i Konferencës:31
Data e miratimit:9.7.1948
Klasifikimi i subjektit: Shërbime punësimi-vendosje në punë
Subjekti: Politikat dhe nxitja e punësimit
Shih ratifikimet e kësaj Konvente

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,

organizuar në San Francisko nga organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës në Sesionin e saj të tridhjetë e një më 17 qershor 1948; dhe

pasi ka vendosur mbi miratimin e disa propozimeve në lidhje me organizimin e shërbimit të punësimit, të përfshira në pikën e katërt të axhendës së sesionit; dhe

pasi ka përcaktuar që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare,

miraton sot më nëntë qershor të vitit një mijë e nëntëqind e dyzet e tetë Konventën e mëposhtme, e cila njihet si Konventa e Shërbimit të Punësimit, 1948

Neni 1

1. Çdo anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Punës, për të cilët kjo Konventë është në fuqi, ruan ose siguron ekzistencën e një shërbimi falas të punësimit publik.

2. Detyra themelore e shërbimit të punësimit, në bashkëpunim me organe të tjera publike apo private të interesuara, është sigurimi sipas nevojës i organizimit më të mirë të mundshëm të tregut të punësimit si pjesë përbërëse e programit kombëtar për arritjen dhe ruajtjen e punësimit të plotë, si dhe zhvillimit dhe përdorimit të burimeve produktive.

Neni 2

Shërbimi i punësimit përbëhet nga një sistem kombëtar zyrash të punësimit nën drejtimin e një autoriteti kombëtar.

Neni 3

1. Sistemi përfshin një rrjet zyrash lokale dhe sipas rastit, edhe zyra rajonale, të mjaftueshme në numër për të operuar në çdo zonë gjeografike të vendit dhe me vendndodhje të favorshme për punëdhënësin dhe punëmarrësit.

2. Organizimi i rrjetit:

a) rishikohet:

i) sa herë që ndodhin ndryshime të rëndësishme, në shpërndarjen e aktivitetit ekonomik dhe fuqisë punëtore; dhe

ii) sa herë që autoriteti kompetent e shikon të arsyeshme rishikimin për të vlerësuar përvojën e fituar gjatë një periudhe të operimit eksperimental; dhe

b) kur rishikime të tilla e bëjnë rishqyrtimin të nevojshëm.

Neni 4

1. Masat e përshtatshme merren nëpërmjet komiteteve këshilluese për bashkëpunimin e

përfaqësuesve të punëdhënësve dhe punëmarrësve në organizimin dhe operimin e shërbimit të punësimit dhe në zhvillimin e politikave të shërbimit të punësimit.

2. Këto masa parashikohen për një ose më shumë komitete këshilluese kombëtare dhe sipas nevojës për komitetet rajonale dhe lokale.

3. Përfaqësuesit e punëdhënësve dhe punëmarrësve në këto komitete emërohen në bazë të një numri të barabartë pas një konsultimi me organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëmarrësve, atje ku këto organizata ekzistojnë.

Neni 5

Politika e përgjithshme e shërbimit të punësimit, përsa i përket dërgimit të punëtorëve në vende të mundshme pune, do të zhvillohet pas konsultimit të përfaqësuesve të punëdhënësve dhe punëmarrësve nëpërmjet komiteteve këshilluese të parashikuara në nenin 4.

Neni 6

Shërbimi i punësimit do të jetë i organizuar në mënyrë që të sigurojë rekrutim dhe vendpunësim efektiv dhe për këtë qëllim:

a) do të ndihmojë punëmarrësin për të gjetur punësim të përshtatshëm dhe punëdhënësit për të gjetur punëtorë të përshtatshëm, dhe më specifikisht:

i) do të regjistrojë aplikues për punësim, do të mbajë shënime mbi kualifikimet e tyre profesionale, përvojën dhe preferencat, do t'i intervistojë ata për punësim, do të vlerësojë nëse kapacitetet e tyre fizike dhe profesionale janë të nevojshme dhe do t'i ndihmojë sipas rastit në sigurimin e këshillimit, kualifikimit apo rikualifikimit profesional;

ii) do të sigurojë nga punëdhënësit informacion të saktë mbi vendet e lira të punës të shpallura prej tyre në zyrat e shërbimit dhe kërkesat që duhet të plotësohen nga punëmarrësit e mundshëm;

iii) do t'i referohet aplikuesve të mundshëm për punësim, me aftësi të përshtatshme dhe kapacitet fizik;

iv) do t'i referohet aplikuesit dhe vendet e lira të punës nga një zyrë punësimi në tjetrën, në rastet kur aplikuesit nuk mund të vendosen në vende të përshtatshme ose kur vendet e lira të punës nuk mund të plotësohen në mënyrë të përshtatshme nga zyra e parë, ose në raste kur rrethana të tjera kushtëzojnë një veprim të tillë;

b) do të ndërmarrë masat e duhura:

i) për të lehtësuar lëvizshmërinë profesionale, me qëllim përshtatjen e ofertës së punës me mundësitë e punësimit në profesione të ndryshme;

ii) për të lehtësuar lëvizjen gjeografike, me qëllim ndihmesën e lëvizjes së punëmarrësve në zona me mundësi punësimi të përshtatshme;

iii) për të lehtësuar transferimin e përkohshëm të punëtorëve nga njëra zonë në tjetrën si një mënyrë për të plotësuar mospërshtatjet e ofertës ose kërkesës së përkohshme lokale për punëtorët;

iv) për të lehtësuar çdo lëvizje të punëtorëve nga njëri vend në tjetrin, të cilat mund të jenë miratuar nga qeveritë përkatëse;

c) do të mbledhë dhe analizojë, në bashkëpunim sipas nevojës me autoritete të tjera dhe me sindikata e drejtori, informacionin më të plotë të mundshëm mbi situatën e tregut të punës dhe ecurinë e tij të mundshme si në nivel kombëtar, ashtu edhe në bazë të llojeve të ndryshme të industrisë, profesioneve dhe zonave, dhe t'ua bëjë të njohura në mënyrë sistematike dhe të shpejtë këtë informacion autoriteteve publike, organizatave përkatëse të punëdhënësve dhe punëmarrësve, si dhe publikut në përgjithësi;

d) do të bashkëpunojë në administrimin e sigurimeve të papunësisë dhe asistencës, si dhe në marrjen e masave të tjera që kanë për qëllim zbutjen e papunësisë; dhe

e) do të ndihmojë sipas nevojës, organe të tjera publike dhe private në fushën e planifikimit social dhe ekonomik, për të siguruar një situatë të favorshme punësimi.

Neni 7

Do të merren masa:

a) për të lehtësuar brenda zyrave të ndryshme të punësimit ndarjen sipas profesioneve dhe fushave, si p.sh. bujqësi dhe çdo fushë tjetër në të cilën një ndarje e tillë mund të jetë e dobishme; dhe

b) për të plotësuar nevojat e kategorive të veçanta të aplikuesve për punësim, p.sh. personat me aftësi të kufizuar.

Neni 8

Në kuadër të punësimit dhe shërbimeve këshilluese profesionale, do të ndërmerren dhe zhvillohen masa të veçanta për të miturit.

Neni 9

1. Stafi i shërbimit të punësimit do të përbëhet nga nëpunës publikë, statusi dhe kushtet e shërbimit të të cilëve janë të pavarura nga ndryshimet e qeverive dhe ndikimet e gabuara të jashtme dhe të kushtëzuara nga nevojat e shërbimit, duke siguruar punësim të qëndrueshëm.

2. Në varësi të kushteve të rekrutimit në shërbimin publik, të cilat mund të jenë përcaktuar në ligjet dhe rregulloret kombëtare, stafi i shërbimit të punësimit rekrutohet mbi bazën e vetme të kualifikimeve për të përmbushur detyrat përkatëse.

3. Mënyra për vërtetimin e këtyre kualifikimeve përcaktohet nga autoriteti kompetent.

4. Stafi i shërbimit të punësimit do të kualifikohet në shkallën e mjaftueshme për përmbushjen e detyrave përkatëse.

Neni 10

Shërbimi i punësimit dhe autoritetet e tjera publike, në bashkëpunim me organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve, si dhe organet e tjera të interesuara, do të marrin të gjitha masat sipas nevojës, për të nxitur shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve të shërbimit të punësimit nga punëmarrësit dhe punëdhënësit mbi baza vullnetare.

Neni 11

Autoritetet kompetente do të marrin masa të nevojshme për të siguruar një bashkëpunim efikas ndërmjet shërbimit të punësimit publik dhe agjencive private të punësimit jo mbi bazën e përfitimit.

Neni 12

1. Në rastin e një anëtari, territori i të cilit përfshin zona të mëdha ku, për arsye të mungesës së dendësisë së popullsisë ose nivelit të zhvillimit të zonës, autoriteti kompetent e konsideron jopraktike zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente, atëherë autoriteti mund të përjashtojë zona të tilla nga zbatimi i Konventës në përgjithësi ose me përjashtime të tilla që sipas nevojës u përkasin sipërmarrjeve apo profesioneve.

2. Çdo anëtar do të tregojë raportin e tij të parë vjetor në zbatim të kësaj Konvente, të paraqitur në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, fushat në të cilat ai propozon të tërhiqet nga dispozitat e nenit ekzistues dhe do të japë arsyet për të cilat bëhen tërheqjet në fjalë; pas datës së raportit të parë vjetor, asnjë anëtar nuk do të tërhiqet nga dispozitat e nenit ekzistues, përveç fushave të përcaktuar si të tilla.

3. Çdo anëtar që tërhiqet nga dispozitat e nenit ekzistues do të tregojë në raportet vjetore pasardhëse fushat në të cilat ai refuzon të drejtën për t'u tërhequr sipas dispozitave të nenit ekzistues.

Neni 13

1. Përsa i përket territoreve të përmendura në nenin 35 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, amenduar nga Kushtetuta e Instrumentit të Amendimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës 1946, të cilat janë të ndryshme nga territoret e përmendura në paragrafët 4 dhe 5 të nenit në fjalë të amenduar në këtë mënyrë, çdo anëtar i Organizatës, i cili ratifikon këtë Konventë, do t'i komunikojë Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës sa më shpejt që të jetë e mundur pas ratifikimit, një deklaratë, ku të deklarojë:

a) zonat në të cilat ai ndërmerr të zbatojë dispozitat e Konventës pa ndryshime;

b) zonat në të cilat ai ndërmerr të zbatojë dispozitat e Konventës kundrejt ndryshimeve, bashkë me detajet e ndryshimeve në fjalë;

c) zonat në të cilat Konventa është e pazbatueshme dhe në raste të tilla fushat në të cilat ajo është e pazbatueshme.

d) zonat për të cilat ai rezervon vendimin.

2. Sipërmarrjet e përmendura në nënparagrafët a dhe b të paragrafit 1 të këtij neni do të çmohen si pjesë përbërëse e ratifikimit dhe kanë fuqinë e tij.

3. Me anë të një deklarate vijuese, çdo anëtar në çdo kohë mund të anulojë tërësisht ose pjesërisht çdo vërejtje të bërë në deklaratën fillestare, duke u mbështetur në nënparagrafët "b" dhe "c" ose "d" të paragrafit 1 të këtij neni.

4. Në përputhje me dispozitat e nenit 16, çdo anëtar, në çdo kohë kur Konventa i nënshtrohet zgjidhjes, mund t'i paraqesë Drejtorit të Përgjithshëm një deklaratë në të cilën ndryshohen kushtet e ndonjë deklarate të mëparshme dhe deklarohet situata ekzistuese në zonat në fjalë.

Neni 14

1. Kur subjekti i kësaj Konvente përfshihet në kompetencat vetëqeverisëse të ndonjë territori jo metropolitan, anëtari përgjegjës për marrëdhëniet ndërkombëtare të atij territori, duke rënë dakord me pushtetin lokal, mund të njoftojë Drejtorin e Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës me anë të një deklarate ku pranohen në emër të territorit detyrimet e Konventës.

2. Një deklaratë ku pranohen detyrimet e kësaj Konvente mund t'i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës:

a) nga dy ose më shumë anëtarë të Organizatës në lidhje me çdo territor, i cili ndodhet nën autoritetin e tyre të përbashkët; ose

b) nga çdo autoritet ndërkombëtar përgjegjës për administrimin e ndonjë territori, në bazë të Kartës së Kombeve të Bashkuara ose ndryshe, në lidhje me çdo territor të tillë.

3. Deklaratat e komunikuara Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës në përputhje me paragrafët paraprirës të këtij neni do të tregojnë nëse dispozitat e kësaj Konvente do të zbatohen në territorin në fjalë pa ndryshim ose amendime; kur deklarata tregon se dispozitat e Konventës do të zbatohen me amendime, paraqiten detajet e amendimeve përkatëse.

4. Me anë të një deklarate pasuese, anëtari, anëtarët ose autoriteti ndërkombëtar në fjalë, në çdo kohë mund të refuzojë tërësisht ose pjesërisht të drejtën për tërheqje nga çdo amendim të specifikuar në çdo deklaratë të mëparshnme.

5. Në përputhje me dispozitat e nenit 17, anëtari, anëtarët ose autoriteti ndërkombëtar në fjalë, në çdo kohë në të cilën kjo Konventë i nënshtrohet zgjidhjes, mund të njoftojë Drejtorin e Përgjithshëm me anë të një deklarate, ku modifikohet çdo aspekt i kushteve të një deklarate të mëparshme dhe deklarohet situata ekzistuese përsa i përket zbatimit të Konventës.

Neni 15

Ratifikimet e mëparshme të kësaj Konvente i komunikohen Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim.

Neni 16

1. Kjo Konventë do të jetë detyruese vetëm mbi ata anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të

Punës ratifikimet e të cilëve janë regjistruar pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

2. Konventa hyn në fuqi 12 (dymbëdhjetë) muaj pas datës në të cilën ratifikimet e dy anëtarëve janë regjistruar pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

3. Pas kësaj, kjo Konventë hyn në fuqi për çdo anëtar 12 (dymbëdhjetë) muaj pas datës në të cilën është regjistruar ratifikimi përkatës.

Neni 17

1. Pasi të kenë kaluar dhjetë vjet nga data në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi, një anëtar i cili ka ratifikuar këtë Konventë mund ta shpallë atë të pavlefshme me anë të një akti komunikuar Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim. Kjo zgjidhje e Konventës nuk do të ketë fuqi deri në një vit pas datës së regjistrimit.

2. Çdo anëtar i cili ka ratifikuar këtë Konventë dhe që brenda vitit që pason mbarimin e periudhës dhjetëvjeçare të përmendur në paragrafin paraprirës, nuk ka ushtruar të drejtën për zgjidhjen e marrëveshjes të parashikuar në këtë nen, ka detyrim ligjor për një periudhë tjetër dhjetëvjeçare dhe pas kësaj, mund ta shpallë këtë Konventë të pavlefshme pas mbarimit të periudhës dhjetëvjeçare sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

Neni 18

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me regjistrimet e të gjitha ratifikimeve, deklarimeve dhe zgjidhjeve të marrëveshjes të komunikuara atij nga ana e anëtarëve të Organizatës.

2. Në njoftimin e anëtarëve të Organizatës mbi regjistrimin e ratifikimit të dytë, Drejtori i Përgjithshëm u tërheq vëmendjen anëtarëve të Organizatës në lidhje me datën në të cilën Konventa hyn në fuqi.

Neni 19

Në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Punës i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuar a për regjistrim detajet e çdo ratifikimi, deklarimi, dhe akti zgjidhjeje të regjistruar prej tij në përputhje me dispozitat e neneve paraprirës.

Neni 20

Kur organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës e çmon të arsyeshme, ai i paraqet Konferencës së Përgjithshme një raport mbi ecurinë e kësaj Konvente dhe shqyrton preferencën e vendosjes në axhendën e konferencës të çështjes së risihikimit të Konventës pjesërisht ose në tërësi.

Neni 21

1. Konferenca mund të miratojë një konventë të re, që rishikon këtë Konventë pjesërisht ose në tërësi, nëse Konventa e re nuk parashikon ndryshe, atëherë:

a) ratifikimi nga një anëtar i konventës së re të rishikuar nënkupton *ipso jure* zgjidhjen e menjëhershme të kësaj Konvente, pavarësisht nga dispozitat e nenit 17 të mësipërm, në momentin kur konventa e re e rishikuar hyn në fuqi;

b) nga data kur Konventa e re e rishikuar hyn në fuqi, kjo Konventë nuk mund të ratifikohet më nga anëtarët.

2. Kjo Konventë mbetet në çdo rast në fuqi në formën dhe përmbajtjen e saj aktuale për ata anëtarë të cilët e kanë ratifikuar atë, por nuk kanë ratifikuar Konventën e rishikuar.

Neni 22

Versionet në gjuhën angleze dhe frënge të tekstit të kësaj Konvente janë njëlloj të barasvlefshme.

LIGJ
Nr.9992, datë 18.9.2008

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS (ILO) "PËR POLITIKËN E PUNËSIMIT, C 122, 1964"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) "Për politikën e punësimit, C 122, 1964".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5900, datë 1.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

KONVENTA E POLITIKËS SË PUNËSIMIT C122, 1964

Konventa mbi politikën e punësimit (Shënim. Data e hyrjes në fuqi: 15.7.1966)
Konventa: C 122
Vendi: Gjenevë
Sesioni i Konferencës: 48
Data e miratimit: 9.7.1964
Klasifikimi i subjektit: Politika e punësimit
Subjekti: Politika dhe nxitja e punësimit
Shih ratifikimet e kësaj Konvente

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,
organizuar në Gjenevë nga organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës në sesionin e saj të dyzet e tetë më 17 qershor 1964; dhe
duke pasur parasysh se deklarata e Filadelfias njeh detyrimin solemn të Organizatës

Ndërkombëtare të Punës për t'u përcjellë kombeve të botës programe, të cilat realizojnë punësim të plotë dhe rritjen e standardeve të jetesës, dhe se në parathënien e Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës parashikohet parandalimi i papunësisë dhe sigurimi i një page të mjaftueshme për të jetuar; dhe

më tej, duke pasur parasysh faktin se në bazë të kushteve të deklaratës së Filadelfias, Organizata Ndërkombëtare e Punës mban përgjegjësi për të shqyrtuar dhe gjykuar mbi lidhjen e politikave ekonomiko-financiare me politikën e punësimit në dritën e objektivit themelor se "të gjithë njerëzit, pavarësisht nga raca, besimi dhe gjinia, gëzojnë të drejtën e mirëqënies materiale dhe zhvillimit të tyre shpirtëror në kushtet e lirisë dhe dinjitetit të sigurisë ekonomike dhe mundësive të barabarta"; dhe

duke pasur parasysh se Deklarata themelore e të drejtave të njeriut parashikon se "çdo njeri gëzon të drejtën e punës, e zgjedhjes së lirë të punësimit, e kushteve të favorshme të punës si dhe të mbrojtjes nga papunësia"; dhe

duke vërejtur kushtet e konventave ndërkombëtare ekzistuese të punës dhe udhëzimeve të lidhjeve të drejtpërdrejta me politikën e punësimit, dhe në veçanti Konventën e shërbimit të punësimit dhe udhëzimet e vitit 1948, udhëzimin këshillues profesional të vitit 1949, udhëzimin e kualifikimit profesional të vitit 1962, si dhe Konventën e diskriminimit (punësimit dhe profesionit) dhe udhëzimin e vitit 1958; dhe

duke marrë në konsideratë se këto instrumente duhet të vendosen në një kuadër më të gjerë të një programi ndërkombëtar për shtrirje ekonomike mbi bazën e një punësimi të plotë, produktiv dhe me zgjedhje të lirë, dhe

pasi është vendosur mbi miratimin e disa propozimeve në lidhje me politikën e punësimit të përfshira në pikën e tetë të axhendës së sesionit; dhe

pasi është përcaktuar që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare, miraton më nëntë qershor një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër Konventën e mëposhtme, e cila mund të referohet si Konventa e politikës së punësimit, 1964.

Neni 1

1. Duke synuar stimulimin e rritjes dhe zhvillimit ekonomik, ngritjen e nivelit të jetesës, plotësimin e kërkesave për fuqi punëtore dhe kapërcimin e papunësisë dhe punësimit të pjesshëm, çdo anëtar deklaron dhe ndjek si objektiv kryesor një politikë aktive të hartuar për nxitjen e punësimit të plotë, produktiv dhe me zgjedhje të lirë.

2. Politika e lartpërmendur ka për qëllim të sigurojë:

a) punësim për të gjithë ata që janë të disponueshëm dhe që kërkojnë të punësohen;

b) punësim sa më produktiv që të jetë e mundur;

c) lirinë e zgjedhjes së punësimit dhe mundësi maksimale për çdo punëtor që të kualifikohet, ta përdorë aftësinë e tij për një punë të përshtatshme, pavarësisht nga raca, ngjyra, seksi, besimi, bindjet politike, kombësia apo origjina sociale.

3. Politika e lartpërmendur merr në konsideratë stadin dhe nivelin e zhvillimit ekonomik dhe marrëdhëniet reciproke ndërmjet objektivave të punësimit dhe objektivave të tjerë ekonomiko-socialë, dhe ndiqet nga metoda, të cilat i përshtaten kushteve dhe praktikave kombëtare.

Neni 2

Me anë të metodave të tilla dhe në shkallën e nevojshme, në varësi të kushteve kombëtare, çdo anëtar:

a) do të vendosë dhe mbajë nën vëzhgim, brenda kuadrit të një politike social-ekonomike të koordinuar, masat që do të ndërmerren për arritjen e objektivave të specifikuar në nenin 1;

b) do të ndërmarrë hapa të tillë sipas nevojës, duke përfshirë sipas rastit edhe krijimin e programeve për zbatimin e këtyre masave.

Neni 3

Në zbatimin e kësaj Konvente, përfaqësuesit e personave të cenuar nga masat që do të ndërmerren, dhe në veçanti përfaqësuesit e punëdhënësve dhe punëmarrësve, do të konsultohen mbi politikat e punësimit me synimin për të marrë plotësisht në konsideratë përvojën dhe pikëpamjet e tyre dhe sigurimin e bashkëpunimit të tyre të plotë në formulimin dhe renditjen e mbështetjes për këto politika.

Neni 4

Ratifikimi zyrtar i kësaj Konvente i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim.

Neni 5

1. Kjo Konventë është e detyrueshme vetëm për ata anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimet e të cilëve janë regjistruar pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

2. Konventa hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën dy anëtarë regjistrohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

3. Pas kësaj, Konventa hyn në fuqi për çdo anëtar, dymbëdhjetë muaj pas datës së regjistrimit të ratifikimit.

Neni 6

1. Pasi të kenë kaluar dhjetë vjet nga data në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi, një anëtar i cili ka ratifikuar këtë Konventë mund ta shpallë atë të pavlefshme me anë të një akti komunikuar Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim. Kjo zgjidhje e Konventës nuk do të ketë fuqi deri në një vit pas datës së regjistrimit.

2. Çdo anëtar, i cili ka ratifikuar këtë Konventë dhe që brenda vitit që pason mbarimin e periudhës dhjetëvjeçare të përmendur në paragrafin paraprirës, nuk ka ushtruar të drejtën për zgjidhjen e marrëveshjes të parashikuar në këtë nen, ka detyrim ligjor për një periudhë tjetër dhjetëvjeçare dhe pas kësaj, mund ta shpallë këtë Konventë të pavlefshme pas mbarimit të çdo periudhe dhjetëvjeçare, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

Neni 7

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me regjistrimet e të gjitha ratifikimeve, deklarimeve dhe zgjidhjeve të marrëveshjes të komunikuara atij nga ana e anëtarëve të organizatës.

2. Në njoftimin e anëtarëve të organizatës mbi regjistrimin e ratifikimit të dytë, Drejtori i Përgjithshëm u tërheq vëmendjen anëtarëve të organizatës në lidhje me datën në të cilën Konventa hyn në fuqi.

Neni 8

Në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Punës i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim detajet e çdo ratifikimi, deklarimi dhe akti zgjidhjeje të regjistruar prej tij në përputhje me dispozitat e neneve paraprirëse.

Neni 9

Kur organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës e çmon të arsyeshme, ai i paraqet Konferencës së Përgjithshme një raport mbi ecurinë e kësaj Konvente dhe shqyrton preferencën e vendosjes në axhendën e konferencës të çështjes së rishikimit të Konventës pjesërisht ose në tërësi.

Neni 10

1. Konfernenca mund të miratojë një konventë të re, që rishikon këtë Konventë pjesërisht ose në tërësi, nëse konventa e re nuk parashikon ndryshe, atëherë:

a) ratifikimi nga një anëtar i konventës së re të rishikuar nënkupton *ipso jure* zgjidhjen e menjëhershme të kësaj Konvente, pavarësisht nga dispozitat e nenit 6 të mësipërm, në momentin kur Konventa e re e rishikuar hyn në fuqi;

b) nga data kur konventa e re e rishikuar hyn në fuqi, kjo Konventë nuk mund të ratifikohet më nga anëtarët.

2. Kjo Konventë mbetet në çdo rast në fuqi në formën dhe përmbajtjen e saj aktuale për ata anëtarë, të cilët e kanë ratifikuar atë, por nuk kanë ratifikuar konventën e rishikuar.

Neni 11

Versionet në gjuhën angleze dhe frënge të tekstit të kësaj Konvente janë njëlloj të barasvlefshme.

LIGJ
Nr.9993, datë 18.9.2008

PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS SË SHITJES SË 85 PËR QIND TË AKSIONEVE TË ARMO, SHA-SË NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE BLERËSIT "AMRA OIL, SHA" DHE KONSORCIUMIT "REFINERY ASSOCIATES OF TEXAS, ANIKA ENTERPRISES & MERCURIA ENERGY GROUP"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet kontrata e shitjes së 85 për qind të aksioneve të ARMO, sha-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe blerësit "AMRA OIL, sha" dhe konsorciumit "Refinery Associates of Texas, Anika Enterprises & Mercuria Energy Group", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në rolin e përfaqësuesit të pronarit shtet, autorizohet që, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të identifikojë dhe të shuajë me kompensim detyrimet debitore dhe kreditore, që institucionet, shoqëritë tregtare shtetërore dhe ARMO, sha-ja kanë ndaj njëri-tjetrit, deri në vlerën që këto detyrime pasqyrohen në bilancin e vitit 2007 të ARMO, sha-së.

Këshilli i Ministrave përcakton detyrimet që do të shuhen me kompensim dhe shumën e këtyre detyrimeve.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5901, datë 1.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.9994, datë 18.9.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7875, DATË 23.11.1994 "PËR MBROJTJEN E FAUNËS SË EGËR DHE GJUETINË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7875, datë 23.11.1994 "Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë", të ndryshuar, neni 23 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 23

1. Personat fizikë ose juridikë mund të ushtrojnë veprimtaritë e mbarështimit të faunës së egër, si dhe të gjuetisë sportive e turistike, kur shpallen fitues në procedurat e konkurrimit publik, të organizuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor ose për pyjet dhe kullotat komunale nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës. Me subjektin fitues lidhet kontratë.

2. Kërkesat që duhet të plotësojnë subjektet për pjesëmarrjen në konkurrimin publik për veprimtarinë e mbarështimit të faunës së egër, si dhe të gjuetisë sportive e turistike, përcaktohen me udhëzim të ministrit.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5902, datë 1.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

VENDIM
Nr.213, datë 29.9.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.4, DATË 19.9.2005 “PËR ZGJEDHJEN E BYROSË DHE PËRBËRJEN E SEKRETARIATEVE TË KUVENDIT”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit, pas këshillimit me kryetarët e grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Neritan Ceka zgjidhet Zëvendëskryetar i Kuvendit në vend të zotit Fatos Beja.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.214, datë 29.9.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR KODIN ZGJEDHOR, NGRITUR ME VENDIMIN NR.192, DATË 30.6.2008, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimn e bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Kodin Zgjedhor,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Kodin Zgjedhor, ngritur me vendimin nr.192, datë 30.6.2008, të ndryshuar, shtyhet deri më 31 tetor 2008.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.1269, datë 17.9.2008

PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE DETYRAT E PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE SHTETËRORE, TË NGARKUARA PËR SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PËRBËRJA, MËNYRA E FUNKSIONIMIT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT QEVERITAR TË TOKËS (KQT)

A. Përbërja dhe mënyra e funksionimit

1. Komisioni Qeveritar i Tokës kryesohet nga zëvendëskryeministri dhe ka në përbërje:

- Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit — zëvendëskryetar;
- Ministrin e Drejtësisë — anëtar;
- Ministrin e Brendshëm — anëtar;
- Ministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit — anëtar;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit — anëtar;
- Drejtorin e Drejtorisë së Politikave të Pyjeve dhe Kullotave, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave — anëtar;
- Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, në Ministrinë e Drejtësisë — anëtar;

- Kryeregjistruesin e Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë anëtar;
- Drejtorin e Përgjithshëm të ALUIZNI-t anëtar;
- Drejtorin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave anëtar;
- Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit të Burimeve dhe Ofrimit të Shërbimeve, në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit anëtar.

2. Anëtarët e KQT-së ndjekin zbatimin e vendimeve të tij në institucionet, që drejtojnë dhe, për vështirësitë që dalin, informojnë, në çdo kohë, kryetarin e këtij komisioni.

3. Mbledhjet e KQT-së zhvillohen në datën dhe orën e njoftuar nga kryetari ose, në mungesë dhe me porosi të tij, nga zëvendëskryetari, jo më pak se një herë në tre muaj, por në raste të veçanta, që vlerësohen nga kryetari, ky komision mund të mblidhet në çdo kohë.

4. Vendimet e KQT-së merren me votim të hapur dhe quhen të vlefshme, kur votojnë "pro" më shumë se 50 për qind e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Anëtarit të KQT-së nuk i lejohet të abstenojë.

Anëtari, që voton kundër, mund të kërkojë që në procesverbalin e mbledhjes të shënohet fakti dhe arsyet e votimit kundër.

B. Detyrat dhe përgjegjësitë

KQT-ja ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Shqyrton dhe miraton, në mbledhjen e parë të çdo fillimviti, programet vjetore të kontrollit dhe të verifikimit, të përgatitura nga komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV-të).

2. Pasi shqyrton propozimet e KV-ve, të sekretariatit teknik apo/edhe kryesisht për masat disiplinore dhe administrative, për të gjitha institucionet, organet, strukturat dhe subjekte të tjera, që, me veprimet ose mosveprimet e tyre, kanë penguar përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga dispozitat e ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", e të akteve nënligjore, në zbatim të tij, si dhe vendimeve të këtij komisioni, merr vendime në përputhje me pikën 5 të nenit 6 të ligjit të sipërpërmendur.

3. Shqyrton ankesat e palëve ndaj veprimeve të KV-ve, të paraqitura pranë KQT-së nga sekretariati teknik, dhe merr vendimet përkatëse.

KQT-ja nuk merr në shqyrtim ankesat, për të cilat KV-të kanë paraqitur kërkesat përkatëse në organet gjyqësore, në kuptim të zbatimit të neneve 10, 12, 13 e 15 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore".

4. Merr vendime për zgjidhjen e konflikteve territoriale, ndërmjet qarqeve për kufijtë e zërit kadastral të tokës bujqësore, në bazë të raporteve paraprake, të përgatitura nga sekretariati teknik.

5. Thërret në raport prefektët, kryetarët e këshillave të qarqeve, kryetarët e komunave dhe/ose bashkive, si dhe drejtuesit e strukturave të tjera shtetërore, veprimtaria e të cilave lidhet me krijimin e titujve të pronësisë mbi tokën, për çdo rast, kur kjo vlerësohet e nevojshme nga kryetari i KQT-së teknik.

6. Merr vendime për mënyrën e organizimit të veprimtarive të KV-ve, mënyrën e kryerjes së verifikimeve, të përgatitjes dhe mbajtjes së dokumentacionit, për llojin e informacionit, që paraqitet në komision, afatet e përmbushjes së detyrimeve për çështje konkrete të shqyrtimit dhe të verifikimit të titujve të pronësisë, mënyrën e bashkëveprimit me institucione të tjera, veprimtaria e të cilave lidhet me verifikimin e titujve të pronësisë, të bazuara në dispozitat e ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij.

II. PËRBËRJA, MËNYRA E FUNKSIONIMIT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E SEKRETARIATIT TEKNIK TË KQT-SË

A. Përbërja dhe mënyra e funksionimit

1. Sekretariati teknik i KQT-së krijohet si strukturë e veçantë, administrative, teknike, pranë

Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në shërbim të KQT-së, dhe përbëhet nga 5 (pesë) punonjës, me përvojë për problemet e pronësisë, të cilët emërohen, lirohen apo shkarkohen nga detyra nga zëvendëskryeministri, pas këshillimeve me Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Sekretariati teknik drejtohet nga drejtori, i cili caktohet nga zëvendëskryeministri. Drejtori i sekretariatit teknik ka pagë të njëjtë me atë të drejtorit të përgjithshëm në ministri.

B. Detyrat dhe përgjegjësitë e sekretariatit teknik

Sekretariati teknik ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Administron të gjitha ankesat, kërkesat ose informacionet e paraqitura me shkrim nga shtetas, institucione ose struktura shtetërore, veprimtaria e të cilave ka për objekt ndarjen e tokës dhe krijimin e titujve të pronësisë mbi të, të regjistruara në protokollin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ankesat, kërkesat dhe informacionet e administruara, në mbështetje të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", grupohen sipas përmbajtjes, rëndësisë dhe përgjegjësisë për zgjidhjen e tyre dhe paraqiten:

a) për shqyrtim në KQT;

b) për shqyrtim ose rishqyrtim në KV.

Kur ankesat, kërkesat dhe informacionet e administruara nuk kanë për objekt të drejtpërdrejtë shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, sekretariati teknik i trajton ato sipas dispozitave të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

2. Përgatit mbledhjet e KQT-së, sipas rendit të ditës, të miratuar paraprakisht nga kryetari i këtij komisioni, i cili u njoftohet anëtarëve pesë ditë para mbledhjes, çështjet e përgjithshme e të veçanta për shqyrtim, si dhe projektvendimet përkatëse.

3. Mban procesverbalin e mbledhjes së KQT-së, që nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari i këtij komisioni.

4. I paraqet KQT-së programet vjetore të dërguara nga KV-të së bashku me komentet, vërejtjet dhe propozimet e tij.

5. Përgatit përgjigjet përkatëse për ankesat, kërkesat dhe informacionet e paraqitura nga shtetasit, institucionet ose strukturat shtetërore për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe të akteve nënligjore, në zbatim të tij.

6. Përgatit aktet e KQT-së, të cilat duhet të përmbajnë numrin e vendimit dhe datën e marrjes së tij, në dy kopje, të nënshkruara nga zëvendëskryeministri dhe të vulosura me vulën e Këshillit të Ministrave. Një kopje ruhet në arkivin e Këshillit të Ministrave dhe kopja tjetër në arkivin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

7. Ia përcjell të gjitha vendimet e KQT-së institucioneve apo individëve, të shoqëruara me shkresë përcjellëse, të nënshkruara nga drejtori i sekretariatit teknik. Të gjitha këto vendime do të vulosen me vulën e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe do të jenë të protokolluara në regjistrat e protokollit të kësaj ministrie.

8. Mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e KV-ve, ndërmjet dy mbledhjeve të KQT-së, nëpërmjet informacioneve të marra prej tyre dhe të kontrollove të drejtpërdrejta, që ushtron mbi to, në zbatim të vendimeve, që merr KQT-ja.

III. PËRBËRJA, MËNYRA E FUNKSIONIMIT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT VENDOR TË VLERËSIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË (KV)

A. Përbërja dhe mënyra e funksionimit

1. Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë krijohet si strukturë e veçantë, pranë prefektit të qarkut, me numër punonjësish, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Anëtarët e komisioneve vendore duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme, të përcaktuara me ligjin e shërbimit civil, si dhe kërkesat e veçanta, të formuluara nga kryetari i KQT-së.

Ata emërohen, lirohen apo shkarkohen nga detyra nga prefekti i qarkut.

Ata duhet të jenë juristë, agronomë apo inxhinierë gjeodetë ose, në pamundësi, teknikë topografë të licencuar.

Komisionet vendore prej 3 anëtarësh duhet të kenë të paktën një jurist.

Komisionet vendore prej 5 anëtarësh duhet të kenë të paktën 2 juristë.

Komisionet vendore prej 6 e 7 anëtarësh duhet të kenë të paktën 3 juristë.

3. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e komisioneve vendore, si dhe të sekretariatit teknik rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

4. Prefekti i qarkut, për raste të domosdoshme, mund të angazhojë pranë KV-ve edhe punonjës të përkohshëm, për të kryer shërbime mbështetëse.

5. Drejtori i KV-së është përgjegjës për organizimin dhe përmbushjen e detyrave. Prefekti përgjigjet para KQT-së për funksionimin e KV-së.

6. KV-ja funksionon si organ kolegjial, si më poshtë vijon:

a) Mbledhjet e këtij komisioni thirren dhe drejtohen nga prefekti. Në mbledhje, prefekti mund të thërrasë edhe drejtues të institucioneve shtetërore, që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e qarkut, drejtues të qeverisjes vendore, të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete, që shqyrtohen.

Në mbledhjen e KV-së paraqitet për shqyrtim informacioni përmbledhës për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektet e interesuara, dokumentacioni, që ka lidhje me çështjen, dhe propozimi përkatës.

Për çdo informacion, përveç relatorit përkatës ose grupit të punës, që ka verifikuar çështjen, çdo pjesëtar i KV-së është i detyruar të shprehë mendimin e vet, i cili shënohet në procesverbalin e mbledhjes. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KV-së, pjesëmarrës në mbledhje.

b) Vendimet merren vetëm në praninë e anëtarëve të KV-së dhe të prefektit, me votim të hapur. Vendimet quhen të vlefshme kur votojnë "pro" më shumë se 50 për qind e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të KV-së.

Prefekti nuk merr pjesë në votim, por është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe respektimin e procedurave.

Të gjitha vendimet e KV-së, përveç atyre, që kanë për objekt kundërvajtjet administrative, nënshkruhen nga prefekti, si dhe nga drejtori i KV-së.

Kur prefekti vëren shkelje të procedurave, ai mund t'i kontestojë vendimet e KV-së, duke mos i nënshkruar ato, e duke i kërkuar më pas KQT-së, ta gjykojë rastin dhe të vendosë për to.

Vendimet e KV-së janë akte administrative dhe përgatiten në përputhje me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Ato vulosen me vulën e institucionit të prefektit dhe u dërgohen të gjitha subjekteve të interesuara.

c) Drejtori ose çdo pjesëtar i KV-së, i autorizuar prej tij, përfaqëson KV-në në proceset gjyqësore të të gjitha shkallëve, që kanë si objekt shqyrtimet e vendimeve të KV-së.

ç) Korrespondenca shkresore e KV-ve me institucionet e tjera dhe shtetasit mbahet në përputhje me të gjitha rregullat, sipas të cilave funksionon administrata e prefektit.

B. Detyrat dhe përgjegjësitë

Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë ka këto detyra e përgjegjësi:

1. Pas verifikimit të dokumentacionit zyrtar dhe veprimtarisë së kryer nga ish-komisionet e tokës së fshatit, komunës dhe/ose bashkisë, si dhe komisioni i tokës së qarkut (ish-rrethit) në procesin e ndarjes së tokës, arrin në përfundime të bazuara ligjore dhe merr vendime:

a) për saktësimin e kufijve të tokës bujqësore, ndërmjet rretheve, brenda juridiksionit të qarkut, ndërmjet komunave dhe/ose bashkive, brenda rrethit, si dhe ndërmjet fshatrave (subjekteve), brenda territorit të komunës dhe/ose bashkisë;

b) për konfliktet ndërmjet familjeve bujqësore ose individëve të një fshati, si dhe ndërmjet tyre dhe ish-komisioneve të ndarjes së tokës;

c) në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore". Vendimet, krahas paraqitjes në gjykatë, i dërgohen edhe zyrës vendore të Avokaturës së Shtetit dhe, për dijeni, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit;

ç) të tjera, në përputhje dhe në zbatim të ligjit, akteve nënligjore, dalë në zbatim të tij, si dhe të vendimeve të KQT-së.

2. Kërkon nga kryetarët e komunave ose të bashkive plotësimin e akteve të marrjes së tokës në

pronësi, për familjet bujqësore ose individët e ish-kooperativave bujqësore, në zbatim të pikës 6 të nenit 8 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore".

Aktet e marrjes së tokës në pronësi, të plotësuara nga kryetarët e komunave dhe/ose bashkive, KV-ja i vlerëson për bazueshmërinë ligjore të tyre dhe ia përcjell seksionit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës (SAMT-së), në qark, kur:

a) vërtetohet se më 1.8.1991 personi, në emër të të cilit lëshohet akti i marrjes së tokës në pronësi, ka qenë anëtar i kooperativës bujqësore dhe plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në vendimin nr.255, datë 2.8.1991 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore";

b) verifikohet se sipërfaqja, për të cilën më 1.8.1991 është lëshuar akti i marrjes së tokës në pronësi, figuron në regjistrat e kadastrave vetëm me cilësinë e zërit "tokë bujqësore" (bimë arash, pemëtore, vreshtë, ullishte);

c) madhësia e sipërfaqes së dhënë për familjen bujqësore është mirëllogaritur, si prodhim i normës për frymë të fshatit me numrin e frymëve të familjes, gjendje më 1.8.1991, në regjistrin e zyrës së gjendjes civile, pavarësisht shtesave ose pakësimeve të këtij numri në periudhën vijuese.

3. Rishqyrton, në rrugë administrative, konfliktet dhe mosmarrëveshjet ndërmjet palëve, në rastet kur kjo është kërkuar me vendim të formës së prerë të organeve gjyqësore. Në këtë rast, KV-ja, brenda 20 ditëve nga data e vendimit të organeve gjyqësore, merr vendim përfundimtar, për zgjidhjen e konfliktit, përmbajtja e të cilit u njoftohet palëve.

4. Evidenton madhësinë dhe vendndodhjen e sipërfaqeve të tokës bujqësore, të liruara nga mbajtja dhe përdorimi i paligjshëm i tyre nga persona fizikë ose juridikë, pas procedurave të realizuara sipas përcaktimeve të nenit 9 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore".

Për tokat e liruara, KV-ja harton procesverbalin përkatës, në përmbajtje të të cilit pasqyrohen vendndodhja (fshati dhe komuna dhe/ose bashkia), numri kadastral i ngastrës, sipas regjistrit të SAMT-së, dhe sipërfaqja, në metër katror, e shoqëruar me një planimetri manuale.

Ky procesverbal i dorëzohet përgjegjësit të SAMT-së së qarkut përkatës.

Përgjegjësi i SAMT-së, pas marrjes së kopjes së procesverbalit dhe në mbështetje të tij, kryen veprimet e dorëzimit të kësaj sipërfaqeje:

a) komunës dhe/ose bashkisë, në juridiksion të së cilës ndodhet toka, për t'u administruar sipas dispozitave të ligjit nr.8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore, në zbatim të tij, në rastet kur toka bujqësore e liruar rezulton me prejardhje nga ish-kooperativat bujqësore, sipas gjendjes më 1.8.1991;

b) zyrës rajonale të AKKP-së, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave me nr.567, datë 5.9.2007 "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave, përcaktimin e pronave, fond pasurie të paluajtshme, për kompensim fizik", dhe nr.868, datë 18.6.2008 "Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore", kur toka bujqësore e liruar rezulton me prejardhje nga ish-ndërmarrjet bujqësore (NB), sipas gjendjes më 1.10.1992.

5. Harton programin e veprimtarive për kontrollet dhe verifikimet, si dhe për zbatimin e vendimeve të KQT-së, në kuptim të shkronjave "b" e "ç" të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore".

Analiza e realizimit të këtij programi bëhet nga KV-ja në fund të çdo viti.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Për çdo pjesëmarrje në mbledhje anëtarët e KQT-së, përfitojnë një shpërblim, në masën 5000 (pesë mijë) lekë.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme që, për çdo vit, të planifikojë, në buxhetin vjetor të institucionit të prefektit të qarkut, si zë të veçantë, një fond për mbulimin e shpenzimeve të KV-së, sipas llogaritjeve të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të paraqitura nga KQT-ja.

3. Ngarkohen KQT-ja dhe Ministria e Brendshme për përgatitjen e akteve për krijimin, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të strukturave të përcaktuara në këtë vendim.

4. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucioni i prefektit të krijojnë kushtet normale dhe bazën materiale të nevojshme për vënien në funksion të plotë të sekretariatit teknik të KQT-së dhe të KV-ve në qarqe.

5. Vendimi nr.230, datë 22.7.1991 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin e komisioneve të tokave", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PASQYRË ANALITIKE
E PËRLLOGARITJES SË KOSTOVE PËR STRUKTURAT SHTETËRORE TË SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË LIGJORE TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE

I-Për PBMUK:

a) kosto e personelit (600-601)

1- Sekretariati teknik i KQT-së	Nr.	Paga bruto vjetore në 000/lekë	Paga bruto (tetor-dhjetor)2008 në 000/lekë
Shuma	(5)	3300	825

- Paga bruto është përcaktuar sipas tabelës përkatëse të VKM për pagat të krahasueshme në ministri.

b) shpenzime operative (602)	vjetore në 000/lekë	(tetor-dhjetor) 2008 000/lekë
1. Për sekretariatin teknik të KQT-së (karburant, dieta, të tjera)	1565	391
2. Për veprimtarinë e KQT-së	455	180
Shuma	2020	571
Totali (a+b) për MBUMK	5320	1396

II- Për KV të administratës së prefektit të qarkut:

a) kosto e personelit (600-601)	Nr.	Paga bruto vjetore në 000/lekë	Paga bruto (tetor-dhjetor) 2008 në 000/lekë
Shuma	60	48450	12306

- Paga e drejtorit të KV-së është barazuar me pagën e përgjegjësit të sektorit në ministri (III-a); ndërsa paga e specialistëve të KV-së është barazuar me pagën e specialistit në ministri (IV-a)

b) Shpenzime operative (602) për KV-të (karburante, dieta, kancelari etj.)	Vjetore 000/lekë	(tetor-dhjetor)2008 000/lekë
	31260	7815
Totali (a+b) për KV-të në qarqe	79710	20121

LIDHJA NR.1

NUMRI I PUNONJËSVE TË STRUKTURAVE SHTETËRORE TË SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË LIGJORE TË DHËNIES SË TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI DHE FINANCIMI NGA BUXHETI I SHTETIT TË VEPRIMTARISË SË TYRE

Nr.	**Emërtimi i institucionit**	**Numri i punonjësve**	**Kosto në 000/lekë Deri në fund të vitit 2008 (tetor-dhjetor)**		
			Gjithsej	Personeli (600-601)	Shpenzime operative 602
I	Për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (Komisioni qeveritar dhe sekretariati teknik	5	571	Mbulohet nga buxheti ekzistues i MBUMK	571
II	Për prefekturat e qarqeve:	60	20121	12306	7815
1	Berat	3	1015.9	624.9	391
2	Dibër	3	1015.9	624.9	391
3	Durrës	6	2031.8	1249.8	782
4	Elbasan	5	1660.5	1009.5	651
5	Fier	6	2031.8	1249.8	782
6	Gjirokastër	3	1015.9	624.9	391
7	Korçë	6	2031.8	1249.8	782
8	Kukës	3	1015.9	624.9	391
9	Lezhë	5	1660.5	1009.5	651
10	Shkodër	6	2031.8	1249.8	782
11	Tiranë	7	2304.1	1394.1	910
12	Vlorë	7	2305.1	1394.1	911
TOTALI (I+II)		65	20692	12306	8386

VENDIM
Nr.1272, datë 17.9.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit të Tiranës, të programeve të mëposhtme të studimit, të ciklit të dytë, sipas fakulteteve:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:

i) Programi i studimit "Kimi", me profilin "Analiza kimike dhe vetitë e lëndës", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në kimi, profili analiza kimike dhe vetitë e lëndës.

ii) Programi i studimit "Matematikë", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në matematikë.

iii) Programi i studimit "Inxhinieri matematike dhe informatikë", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri matematike dhe informatikë.

iv) Programi i studimit "Informatikë", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të

dytë, DND, në informatikë.

b) Në Fakultetin e Shkencave Sociale:

i) Programi i studimit "Filozofi sociale", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në filozofi sociale.

ii) Programi i studimit "Shkenca politike", me profilin "Teoritë politike", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në shkenca politike, në profilin teori politike.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin e Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1273, datë 17.9.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, të programeve të mëposhtme të studimit, të ciklit të dytë, sipas fakulteteve:

a) Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike:

i) Programi i studimit "Inxhinieri tekstili dhe mode", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri tekstili dhe mode.

b) Në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit:

i) Programi i studimit "Inxhinieri ndërtimi", me profile:

- Ndërtim dhe administrim;
- Strukturist;
- nfrastrukturë e transportit.

Në përfundim të këtij programi do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri ndërtimi, profili ndërtim dhe administrim;
- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri ndërtimi, profili strukturist;
- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri ndërtimi, profili infrastrukturë e transportit.

ii) Programi i studimit "Inxhinieri hidroteknikë", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri hidroteknikë.

iii) Programi i studimit "Inxhinieri gjeodezi", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri gjeodezi.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1274, datë 17.9.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, të programeve të mëposhtme të studimit, të ciklit të dytë:

i) Programi i studimit "Ekonomi dhe politika agrare", me profol:

- Zhvillim rural i integruar;
- Ekonomia dhe politikat e zhvillimit agrar.

Në përfundim të këtij programi të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në ekonomi dhe politika agrare, me profil zhvillim rural i integruar;
- Diplomë e niveli të dytë, DND, në ekonomi dhe politika agrare, me profil ekonomia dhe politikat e zhvillimit agrar;

ii) Programi i studimit "Financë-kontabilitet", me profil:

- Financë;
- Kontabilitet.

Në përfundim të këtij programi të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në financë-kontabilitet, me profil financë;
- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në financë-kontabilitet, me profil kontabilitet.

iii) Programi i studimit "Menaxhim agrobiznesi", me profil:

- Administrim i ndërmarrjeve;
- Marketing.

Në përfundim të këtij programi të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në menaxhim agrobiznesi, me profil administrim i ndërmarrjeve;
- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në menaxhim agrobiznesi, me profil marketing.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin Bujqësor të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1275, datë 24.9.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 25 shtator 2008, të dy autokolonave dhe trupave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

a) Autokolona e parë, me 11 (njëmbëdhjetë) automjete dhe 13 (trembëdhjetë) trupa;

b) Autokolona e dytë, me 13 (trembëdhjetë) automjete dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 26 shtator 2008, të tri autokolonave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

a) Autokolona e parë, me 14 (katërmbëdhjetë) automjete dhe 28 (njëzet e tetë) trupa;

b) Autokolona e dytë, me 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 30 (tridhjetë) trupa;

c) Autokolona e tretë, me 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 30 (tridhjetë) trupa ushtarake.

3. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 27 shtator 2008, të dy autokolonave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

a) autokolona e parë, me 11 (njëmbëdhjetë) automjete dhe 13 (trembëdhjetë) trupa;

b) autokolona e dytë, me 13 (trembëdhjetë) automjete dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) trupa.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

5. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

6. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1276, datë 25.9.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE

ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit – Qafë-Thanë, në datën 28 shtator 2008, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë, nga 7 (shtatë) automjete dhe 80 (tetëdhjetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 30 shtator 2008, të tri autokolonave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

a) Autokolona e parë, me 13 (trembëdhjetë) automjete dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) trupa;

b) Autokolona e dytë, me 20 (njëzet) automjete dhe 40 (dyzet) trupa;

c) Autokolona e tretë, me 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 30 (tridhjetë) trupa.

3. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit – Qafë-Thanë, në datën 2 tetor 2008, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 3 (tri) automjete dhe 78 (shtatëdhjetë e tetë) trupa.

4. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit – Qafë-Thanë, në datën 3 tetor 2008, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 7 (shtatë) automjete dhe 14 (katëmbëdhjetë) trupa.

5. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për datat 28 shtator, 2 dhe 3 tetor 2008 është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për datën 30 shtator 2008 është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

6. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

7. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1287, datë 24.9.2008

PËR HAPJEN, NË QYTETIN E LUSHNJËS, TË FILIALEVE, PËRKATËSISHT, TË FAKULTETIT TË EKONOMISË E TË AGROBIZNESIT DHE TË FAKULTETIT TË

BUJQËSISË E TË MJEDISIT, TË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS, DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË PARË, NË KËTO FILIALE, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 1, 11, pika 2, shkronja "b", 26, 33, 42 e 75, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në qytetin e Lushnjës, të filialeve, të Fakultetit të Ekonomisë e të Agrobiznesit dhe të Fakultetit të Bujqësisë e të Mjedisit, si njësi përbërëse të Universitetit Bujqësor të Tiranës.

2. Hapjen e programeve të studimit, të ciklit të parë, "Drejtimi i fermave dhe i agrobiznesit" dhe "Financë-kontabilitet", në filialin e Fakultetit të Ekonomisë dhe të Agrobiznesit, të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Në përfundim të këtyre programeve të studimit përfitohen, përkatësisht, diplomë e nivelit të parë, DNP, për "Drejtim të fermave dhe agrobiznesit", dhe diplomë e nivelit të parë, DNP, në "Financë-kontabilitet".

3. Hapjen e programit të studimit, të ciklit të parë, "Hortikulturë", në filialin e Fakultetit të Bujqësisë e të Mjedisit, të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Në përfundim të këtij programi studimi do të jepet diplomë e nivelit të parë, DNP, në "Hortikulturë".

4. Këto programe studimi realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

5. Numri i kuotave të pranimeve, në secilin nga këto programe studimi, me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009, është 25.

6. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që regjistrohen në vitin e parë, në këto programe studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Universitetin Bujqësor të Tiranës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1288, datë 24.9.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, PRANË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, në Fakultetin e Mësuesisë, të

programeve të mëposhtme të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë:

a) në lëndët "Gjuhë-letërsi", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët gjuhë-letërsi;

b) në lëndët "Histori-gjeografi", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën histori-gjeografi.

2. Programet e studimeve, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastër.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1289, datë 24.9.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, PRANË UNIVERSITETIT "FAN.S.NOLI", KORÇË, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë universitetit "Fan.S.Noli", Korçë, në Fakultetin e Mësuesisë, të programeve të mëposhtme, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë:

a) në lëndët "Gjuhë-letërsi", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët gjuhë-letërsi;

b) në lëndët "Gjuhë angleze", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë angleze.

2. Programet e studimeve, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin "Fan.S.Noli", Korçë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Fan.S.Noli", Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1290, datë 24.9.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË

MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, PRANË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR XHUVANI", ELBASAN, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, të programeve të mëposhtme të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë:

a) në lëndët "Gjuhë-letërsi", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët gjuhë-letërsi;

b) në lëndët "Biologji-kimi", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët biologji-kimi;

c) në lëndën "Gjuhë italiane", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë italiane;

ç) në lëndën "Gjuhë gjermane", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë gjermane;

d) në lëndën "Gjuhë frënge", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë frënge;

dh) në lëndët "Gjuhë angleze", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, mastër i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë angleze.

2. Programet e studimeve master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë realizohen me 60 kreditë dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1291, datë 24.9.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MESUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, PRANË UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI", SHKODËR, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, të programeve të mëposhtme të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë:

a) në lëndët "Gjuhë-letërsi", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët gjuhë - letërsi;

b) në lëndët "Matematikë - fizikë", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët matematikë - fizikë;

c) në lëndët “Matematikë-informatikë”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët matematikë - informatikë;

c) në lëndët “Biologji-kimi”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët biologji- kimi;

d) në lëndën “Gjuhë angleze”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplome, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë angleze;

dh) në lëndën “Gjuhë gjermane”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët gjuhë gjermane.

2. Programet e studimeve master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë, bazë realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.3, datë 12.2.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Artan Hoxha	Anëtar
Gani Dizdari	Anëtar
Nikoleta Kita	Anëtare
Agron A.Lamaj	Anëtar
Evgjeni Sinoimeri	Anëtare
Shpresa Beçaj	Anëtare
Ardian Dvorani	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Irma Bala	Anëtare
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar

në seancat gjyqësore të datës 10.1.2008 dhe datës 12.2.2008 morën në shqyrtim çështjen civile

nr.8 Akti, që u përket palëve:

PADITËS: Thoma Nasi, prezent, i papërfaqësuar me avokat.

E PADITUR: Dega e tatim taksave Lushnjë, në mungesë.

OBJEKTI I PADISË: Anulim i aktit administrativ të detyrimit tatimor, në shumën e 95 506 lekëve, të datës 7.7.2004.

Baza ligjore: Neni 324 e vijues i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr.712, datë 3.7.2007, ka vendosur:

"Të deklarojë mungesën e juridiksionit gjyqësor për gjykimin e kësaj mosmarrëveshjeje civilo - administrative", *duke arsyetuar se mosmarrëveshja administrative nuk i është nënshtruar shqyrtimit në themel nga ana e organeve administrative, sikurse parashikon neni 55 i ligjit nr.8560 "Për procedurat tatimore", i cili rregullon marrëdhëniet juridike që lindin në fushën e mbledhjes së detyrimeve tatimore.*

Kundër vendimit të mësipërm **ka ushtruar ankim të veçantë paditësi Thoma Nasi**, i cili kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë për mungesë juridiksioni dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim po në gjykatën e shkallës së parë, për këto shkaqe:

- I kam ndjekur të gjitha shkallët e apelimit administrativ, sipas nenit 55 të ligjit nr.8560 "Për procedurat tatimore", për aktin administrativ të regjistrimit me iniciativë nga dega e tatim taksave Lushnjë si objekt tatimpagues dhe për detyrimin ndaj kësaj dege të shumës 95 506 lekë jam njoftuar në datën 13.10.2006, kur unë kam shkuar vetë në degën e tatimeve për të marrë një dokument, pasi po të mos shkoja, ky njoftim detyrimi nuk do të ishte bërë i ditur, kjo shumë përbëhet prej 10 000 taksë vendore, *32 000* detyrim tatimor tatim fitimi i thjeshtuar dhe 53 506 lekë sigurime shoqërore, shumë e cila në vitin 2004 nuk ishte detyrim i degës së tatim taksave.

- Duke mos pasur dijeni për shkallët e ankimit administrativ, pasi unë jam invalid (me një dorë), i jam drejtuar gjykatës për këtë padrejtësi që unë mendoj se më ishte bërë.

- Pas vendimit nr.1018, datë 13.11.2006 të gjykatës për pushimin e kërkesës sime, e cila më udhëzoi që më parë të ndjek rrugën administrative të apelimit, i jam drejtuar Drejtorisë së Apelimit, e cila mori vendim për mosmarrjen në shqyrtim të kërkesës sime, pasi kanë kaluar afatet ligjore.

- Edhe nga Komisioni i Apelimeve nuk u mor në shqyrtim kërkesa ime.

- Nga mosnjohja e shkallëve të apelimit, si dhe nga fakti se detyrimi më është njoftuar nga data 7.7.2004 më datën 13.10.2006, pra 2 vjet e tre muaj me vonesë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 18.10.2007, me arsyetimin se për këtë çështje *"...ka vend të shqyrtohet në Kolegje të Bashkuara për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore, për shkak se ka qëndrime të ndryshme për çështje të ngjashme midis Kolegjeve të Gjykatës së Lartë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e nenit 55/2 dhe 59 të ligjit "Për procedurat tatimore".*

Në nenin 55 të ligjit të mësipërm parashikohet se apelimi kundër akteve të administratës tatimore bëhet në organet e apelimit tatimor, të cilat kanë shkallë hierarkike nga më i ulëti te më i larti. Në paragrafin 2 të këtij neni parashikohet se hierarkia e apelimit tatimor nga më i ulëti te më i larti është: *"a) dega e tatimeve në rrethe për tatimet e taksave nacionale; b) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; c) Komisioni i Apelimit të Tatimeve pranë Ministrisë së Financave; d) sistemi gjyqësor"*. Në fjalinë e fundit të këtij neni parashikohet se: ***"një çështje nuk mund të shqyrtohet në një nivel më të lartë apelimi pa u shqyrtuar në nivelin më të ulët***".

Neni 59 i ligjit nr.8560 parashikon se: *"Tatimpaguesi, pasi ka ndjekur të gjitha shkallët e ankimimit administrativ të parashikuar në këtë ligj, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës"*, ka vendosur:

"Kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikim të praktikës gjyqësore", duke shtruar këto çështje:

1. Në rastin kur subjekti tatimor ka bërë ankim nga ana formale juridike deri në organet më të larta të hierarkisë së apelimeve tatimore, dhe këto organe nuk e kanë marrë në shqyrtim ankimin, me argumentimin e mosplotësimit prej subjektit të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 55 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 dhe udhëzimit nr.5, datë 30.1.2006 "Për procedurat tatimore" *(pra, se ka kaluar afati ligjor i përcaktuar për kryerjen e këtij apelimi, ose aktit administrativ i mungojnë elementet e një akti të rregullt),* a ka të drejtë subjekti t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar prej saj që të verifikohen pretendimet e tij mbi respektimin ose jo, gjatë ankimit në rrugë administrative, të rregullave të natyrës procedurale?

2. Shqyrtimi vetëm nga ana formale juridike i çështjes nga organet e ankimimit administrativ,

a presupozon se në kuptim të nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile dhe 59 të ligjit "Për procedurat tatimore" ankimi administrativ quhet i ezauruar?

3. Parashikimi në ligjin nr.8560, në nenin 55/2 se *"... një çështje nuk mund të shqyrtohet në një nivel më të lartë apelimi pa u shqyrtuar në nivelin më të ulët",* a është pengesë ligjore që gjykata të bëhet kompetente për të shqyrtuar pretendimet e subjektit tatimor për motive procedurale si më sipër?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Shpresa Beçaj dhe Ardian Nuni, dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

I. Nga të dhënat e akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore, rrethanat e çështjes, paraqitur në mënyrë kronologjike, rezultojnë si më poshtë:

1. Paditësi ka kryer aktivitet privat për shitjen e artikujve të ndryshëm ushqimorë në Fier-Seman, komuna Gradishtë, Lushnjë.

2. Me shkresën nr.914, prot., datë 31.3.2004 të kryetarit të degës së tatimeve Lushnjë është urdhëruar sektori i Policisë Tatimore Lushnjë të kryejë *"mbylljen e aktivitetit të subjektit Thoma Nasi ... deri në çastin e pajisjes me certifikatë tatimore"*.

3. Policia Tatimore i ka mbyllur aktivitetin paditësit në datën 31.3.2004 dhe me shkresën nr.907/1, prot., datë 7.6.2004 informon degën e tatimeve Lushnjë për mbylljen e aktivitetit të subjekteve të palicencuara në komunën Gradishtë, midis të cilëve edhe për Thoma Nasin (nr.3 i rubrikës).

4. Me shkresën nr.907/3, prot., datë 16.6.2004, kryetari i degës së tatimeve Lushnjë kërkon informacion prej sektorit të Policisë Tatimore që të rikonfirmojë nëse subjektet të cilave iu është bllokuar aktiviteti, e ushtrojnë atë në kundërshtim me vendimin e bllokimit.

5. Dega e tatimeve Lushnjë ka nxjerrë "Njoftim detyrimi" nr.2797, datë 10.10.2006. Sipas këtij akti, nga verifikimet e Policisë Tatimore gjatë vitit 2004, paditësi Thoma Nasi është gjendur në ushtrim të aktivitetit privat *"pa u regjistruar në degën e tatimeve"*. Bazuar në nenin 32/2, pika 1 të ligjit nr.8438, datë 12.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar), zyra e regjistrimit e degës së tatimeve Lushnjë ka regjistruar paditësin si subjekt të tatueshëm. *"Sipas deklarimeve të Policisë Tatimore"* dhe përllogaritjeve të datës 7.7.2004, ai është ngarkuar me detyrim tatimor në shumën prej 95 506 lekësh, që përbëhet prej 10 000 lekë taksë vendore, 32 000 lekë detyrim tatimor tatim fitimi i thjeshtuar dhe 53 506 lekë sigurime shoqërore.

6. Paditësi është vënë në dijeni të këtij njoftim detyrimi në datën 13.10.2006 dhe e ka kundërshtuar atë në rrugë gjyqësore. Me vendimin nr.1018, datë 13.11.2006 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka pushuar gjykimin e padisë, për shkak se paditësi ka hequr dorë nga gjykimi i saj.

7. Ndërkohë, ai ka bërë ankim në Drejtorinë e Apelimit Tatimor. Kërkesa e tij ankimore është protokolluar me nr.11311, datë 14.11.2006 (në dosjen gjyqësore nuk ndodhet ndonjë akt që të pasqyrojë mënyrën e depozitimit të ankimit, dorazi apo nëpërmjet shërbimit postar).

8. Me shkresën nr.prot.11311/1, datë 11.12.2006, Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka vendosur mosshqyrtimin e *apelimit administrativ* për shkak të kalimit të afatit ligjor.

9. Kundër vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor paditësi ka paraqitur ankim në Komisionin e Apelimit Tatimor pranë Ministrisë së Financave. Me vendimin nr.806, datë 16.1.2007, ky Komision ka vendosur: *"... të rrëzojë kërkesën e subjektit, pasi dokumentacioni i administruar pranë KAT-it nuk është i plotë sipas kërkesave të nenit 55 të ligjit të sipërcituar, dhe udhëzimit nr.2, datë 30.1.2006 "Për procedurat tatimore", si dhe nuk vërtetohet kryerja e shkallës së parë të apelimit ..., tatimpaguesi, pasi ka ndjekur të gjitha shkallët e ankimit administrativ të parashikuar në këtë ligj, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës"*.

10. Pasi është njohur me vendimin e organit më të lartë të apelimit në rrugë administrative,

paditësi i është drejtuar gjykatës me padi.

11. Gjatë gjykimit ka parashtruar se në fillim të vitit 2004 ka zhvilluar aktivitet privat, por për një kohë shumë të shkurtër, pasi nga organet tatimore është mbyllur. Në tetor 2006, kur paraqitet pranë palës së paditur për të tërhequr një vërtetim, vihet në dijeni se pala e paditur ka kryer regjistrimin e tij si subjekt privat dhe ka përllogaritur detyrimet fiskale që duhet të paguajë për vitin 2004. Pretendon se nuk ka kryer aktivitet që nga momenti që Policia Tatimore e ka mbyllur atë, si dhe sigurimet shoqërore i ka paguar në komunë dhe njoftim vlerësimi është nxjerrë në kundërshtim me ligjin e me gjendjen e faktit.

12. Në prapësimet, pala e paditur ka parashtruar se paditësi është regjistruar me nismën e organeve tatimore dhe i është përllogaritur detyrimi tatimor për vitin 2004. Ankimi administrativ është bërë jashtë afatit. Paditësi nuk ka shlyer detyrimin sipas nenit 43 të ligjit për procedurat tatimore dhe për këto shkaqe çështja duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor.

13. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, ka nxjerrë çështjen objekt gjykimi jashtë juridiksionit gjyqësor, me arsyetimin se *"... rezulton se nga ana e paditësit nuk është shteruar rruga hierarkike e apelimit administrativ të detyrimit të tij tatimor, pasi kërkesa e tij ankimore nuk është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve". Në vijim të arsyetimit, kjo gjykatë parashtron që "në rastin konkret ligji i veçantë (ligji për procedurat tatimore), i cili ka përparësi ndaj ligjit të përgjithshëm (nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile), parashikon mungesën e juridiksionit gjyqësor për gjykimin e kësaj çështjeje, përderisa nuk është respektuar procedura e parashikuar në këtë ligj"*.

14. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim të veçantë paditësi.

II. Vlerësimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë:

15. Kolegjet e Bashkuara çmojnë të parashtrojnë opinionin e tyre ligjor në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga gjykata e faktit si në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore, ashtu dhe për vijueshmërinë e çështjes në gjykim.

16. Kolegjet e Bashkuara, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, vendimin e gjykatës dhe në analizë juridike të tyre, në raport me dispozitat kushtetuese dhe të legjislacionit përkatës fiskal, vlerësojnë se një pjesë e pretendimeve të ngritura nga ankuesi qëndrojnë. Gjykata e shkallës parë, në nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes që i është shtruar për zgjidhje, ka zbatuar keq ligjin.

17. Për rastin konkret, në rrethanat e një hetimi gjyqësor jo të plotë e të gjithanshëm, nxjerrja jashtë juridiksionit gjyqësor bën që ankuesit t'i mohohet e drejta e ankimit, të garantuar në dispozitat kushtetuese, që, nga njëra anë, sjell mohimin e së drejtës për t'u gjykuar dhe dëgjuar nga gjykata dhe, nga ana tjetër, mosushtrimin e një kontrolli gjyqësor mbi aktin administrativ; elemente këto të domosdoshme për një proces të rregullt ligjor.

18. Në nenet 6 e 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe në nenin 42 të Kushtetutës[1] së Republikës së Shqipërisë është parashikuar në mënyrë të shprehur e drejta e individit për një ankim efektiv dhe për një proces të rregullt ligjor. Në kuptim të dispozitës kushtetuese kjo e drejtë nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por ajo shtrihet edhe në atë me karakter administrativ, siç është rasti në shqyrtim.

19. Shqyrtimi i akteve të administratës tatimore është i lidhur pazgjidhshmërisht me zbatimin e procedurave të përcaktuara si në ligjin për procedurat tatimore, ashtu edhe në Kodin e Procedurave Administrative. Sipas neneve 21, 56 e 57 (të ndryshuar) të ligjit për procedurat tatimore, Drejtoria e Apelimit Tatimor dhe Komisioni i Apelimit të Tatimeve janë parashikuar si organe administrative me kompetenca të plota për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative në fushën e tatimeve; kjo në përputhje edhe me nenin 13 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

20. Në ligjin për procedurat tatimore është parashikuar që veprimtaria e Drejtorisë së Apelimit Tatimor dhe Komisionit të Apelimit të Tatimeve t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor (n. 59[2]).

---

1 Neni 42 "1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.".

2 Neni 59 i ligjit "Për procedurat tatimore:"Tatimpaguesi, pasi ka ndjekur të gjitha shkallët e ankimit administrativ të parashikuar në këtë ligj, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.".

21. Për rastin konkret, paditësi, bazuar në dispozitat e sipërcituara të ligjit për procedurat tatimore, ka ushtruar ankim administrativ, duke kërkuar shfuqizimin e njoftim detyrimit nr.2797, prot., datë 10.10.2006.

21.1 Drejtoria e Apelimit Tatimor, me aktin nr.1131/1 prot., datë 11.12.2006, ka vendosur mosshqyrtimin e apelimit administrativ, për arsye se janë *"kaluar afatet ligjore të përcaktuara për kryerjen e këtij apelimi" (neni 55, pika 3).*

21.2 Komisioni i Apelimit Tatimor, i vënë në lëvizje nëpërmjet ankimit të paditësit, me vendimin nr.806, datë 16.1.2007, është shprehur: *"të rrëzojë kërkesën e subjektit, pasi dokumentacioni i administruar pranë KAT nuk është i plotë sipas kërkesave të nenit 55 të ligjit të sipërcituar, dhe udhëzimit nr.2, datë 30.1.2006 "Për procedurat tatimore", si dhe nuk vërtetohet kryerja e shkallës së parë të apelimit. Në mbështetje të nenit 59 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999, i ndryshuar, tatimpaguesi, pasi ka ndjekur të gjitha shkallët e ankimit administrativ të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës".*

22. Paditësi, me pretendimin se nga veprimtaria e organeve të administratës tatimore dhe nga aktet e nxjerra prej tyre i janë cenuar interesa të ligjshme, si dhe në rrethanat kur nuk ka gjetur zgjidhje konkrete të cenimit të këtij interesi as nga organet më të larta të kësaj administrate, bazuar në nenin 59 të ligjit për procedurat tatimore, nenin 18/b të Kodit të Procedurës Administrative dhe nenin 324 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, i është drejtuar gjykatës.

23. Në thelb, objekt i mosmarrëveshjes së shtruar para gjykatës është paligjshmëria e tri akteve administrative, si dhe procedura e ndjekur gjatë nxjerrjes së tyre.

24. Në vështrim të përgjigjeve të dhëna nga organet administrative dhe arsyetimit të vendimit gjyqësor, Kolegjet e Bashkuara konstatojnë se gjykata e faktit, megjithëse ka shqyrtuar çështjen për disa seanca gjyqësore, duke mos kryer *"një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin"* (neni 14 i Kodit të Procedurës Civile), nuk i ka dhënë përgjigje qëndrimit të organeve administrative, nëse ato nuk kanë pasur motivin e arsyeshëm apo janë ndodhur përpara pamundësisë ligjore për të marrë në shqyrtim në themel çështjen që iu është paraqitur nëpërmjet ankimit. Për rrjedhojë, vendimi i kësaj gjykate është i cenueshëm.

25. Aktualisht jemi në rrethanat kur personit të interesuar, që ka nisur procedurën administrative, i kanë shteruar mjetet ligjore të kundërshtimit të akteve administrative dhe me anë të padisë i ka bërë ato objekt të juridiksionit gjyqësor. Çështja shtrohet nëse ka konsumuar paditësi të drejtën e ankimit administrativ në organet e administratës në rrugë hierarkike që të mund të vërë në lëvizje juridiksionin gjyqësor.

26. Në vështrim të neneve 31, 324 e 325 të Kodit të Procedurës Civile, objekt shqyrtimi gjyqësor është padia e subjektit që kërkon shfuqizimin e aktit administrativ, me pretendimin se janë të paligjshëm *"dhe se atij i cenohen interesat dhe të drejtat e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë".*

27. Në harmonizim me përmbajtjen e dispozitave kushtetuese të sipërcituara, gjykatat e faktit shqyrtojnë jo vetëm paligjshmërinë apo pathemelësinë e aktit, por dhe ligjshmërinë e veprimeve/mosveprimeve të organeve të administratës, jo vetëm për t'iu përgjigjur në kohë subjekteve për kërkesat/ankimet që ato paraqesin, por edhe nëse veprimet e kryera prej tyre janë të ligjshme apo jo dhe nëse ato iu përgjigjen rrethanave të faktit.

27.1 Pikërisht ky kontroll realizohet nga gjykata. Në vështrim edhe të neneve 18/b e 137 të Kodit të Procedurave Administrative, gjykata ushtron kontroll për ligjshmërinë e aktit dhe veprimeve të organeve të administratës publike, të cilat kontestohen para gjykatës, për shkak se, sipas pretendimeve të palës paditëse, kanë cenuar e kufizuar të drejta e interesa të ligjshme, duke e detyruar atë të paguajë një detyrim jo të bazuar në ligj e në gjendjen e faktit.

28. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me juridiksionin dhe kompetencën, të cilat gjejnë rregullim në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe në ligje të tjera. Kuptimi, interpretimi dhe zbatimi i drejtë i këtyre dispozitave është detyrë e gjykatave.

29. Nuk është objekt i këtij gjykimi themeli i çështjes, por parë në këndvështrimin ligjor të mësipërm, kur për rastin konkret pretendohet se nxjerrja e njoftim vlerësimit tatimor, veprimet e administratës tatimore, përfshirë dhe ato të dy organeve të shqyrtimit të ankimit administrativ, janë në kundërshtim me ligjin, paditësi legjitimohet t'i drejtohet gjykatës. Legjitimimi *(locus standi)* i këtij

subjekti konsiston në kuptimin që ai ka të drejtën për të vënë në lëvizje një proces gjyqësor kundër një akti administrativ.

30. Kolegjet e Bashkuara kanë detyrimin kushtetues që buron nga neni 141/2 i Kushtetutës, për t'i dhënë neneve 55 të ligjit për procedurat tatimore kuptimin e duhur, duke e qartësuar atë e duke shmangur kundërthëniet me dispozitat e tjera të legjislacionit procedural administrativ e atij civil. Në funksion të këtij qëllimi, interpretimi i njësuar i kësaj dispozite duhet të bëhet në mënyrën që është më e favorshme për palën që kërkon të përfitojë prej saj, që në rastin konkret është subjekti tatimor mbi të cilin *rëndon një ngarkesë tatimore*.

31. Kolegjet e Bashkuara, në interpretim të dispozitave në të cilat referon kjo çështje, në analizë të termave të përdorur në formulimin e këtyre dispozitave, si dhe koncepteve që ato formësojnë, çmojnë të nevojshme të argumentojnë se kuptimi i tyre, që lidhet me shkallët hierarkike të apelimit tatimor, duhet parë i lidhur ngushtë me të gjithë procesin ligjor që duhet të ndjekë tatimpaguesi e që përbëhet nga ankimi që i përket juridiksionit administrativ dhe organeve të përcaktuara në germat "a", "b" dhe "c" të nenit 55 dhe nga ankimi/padia që i përket juridiksionit gjyqësor (germa "ç").

31.1 Pra, në vështrim të përmbajtjes të nenit 55, pavarësisht terminologjisë jo koherente të përdorur në krahasim edhe me dispozitat e tjera të këtij ligji apo edhe të legjislacionit administrativ dhe atij procedurial civil, apelimi tatimor ka të bëjë me dy instanca që u përkasin juridiksioneve të ndryshme, atë që i përket juridiksionit administrativ dhe atë të juridiksionit gjyqësor.

31.2 Për nga formulimi, kjo dispozitë e ka renditur gjykatën si pjesë e *"apelimit tatimor"* dhe si një nga shkallët e këtij apelimi, por në interpretim të tërësisë së dispozitave kushtetuese[3] (nenet 4, 7 e 135), dispozitave të legjislacionit fiskal e atij procedural civil, gjykata nuk është shkallë e ankimit apo apelimit administrativ ose pjesë e hierarkisë së organeve administrative që shqyrtojnë këtë apelim. Gjykata është pjesa qenësore e një pushteti të veçantë dhe jo shkallë e hierarkisë së apelimit administrativ.

32. Ankimi administrativ është mjeti fillestar juridik i subjekteve të interesuara, mbajtësve të *"të drejtave dhe interesave të ligjshme,* të cilat preken nga vendimet që merren ..." nga organet e administratës publike, për të nisur një procedim administrativ e që gjatë këtij procedimi administrativ, kanë të drejtë *"... të marrin pjesë në të ..."* (neni 45/1 i Kodit të Procedurave Administrative dhe neni 56 i ligjit për procedurat tatimore).

33. Paraprakisht evidentojmë se organet e administratës tatimore, që ligji u ka njohur të drejtën e shqyrtimit të apelimit administrativ, nuk janë në funksione *quasi gjykatë*, por organe të administratës publike që ushtrojnë të drejtën e kontrollit të brendshëm ndaj organeve më të ulëta tatimore.

34. Ndërsa gjykata vihet në lëvizje nga palët nëpërmjet padisë dhe personit që bën pretendimin me anë të saj, i është njohur e drejta *"... për t'u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo"* (nenet 2§1 dhe 31§1 të Kodit të Procedurës Civile).

35. Në vështrim të legjislacionit në fuqi, nenit 6, 13 të Konventës për të Drejtat e Njeriut, neneve 17, 41, 42 të Kushtetutës, si dhe qëndrimeve interpretuese të Gjykatës Kushtetuese, janë gjykatat e zakonshme ato që shqyrtojnë zbatueshmërinë e parimeve të procesit të rregullt ligjor nga ana e administratës shtetërore si në nxjerrjen e aktit administrativ, ashtu dhe gjatë procedurës së kundërshtimit të këtij akti në rrugë administrative e të kundërshtuar në një gjykim individual (akte të karakterit individual dhe jo normativ -përgjithshëm për ato që nuk janë penguar nga neni 325 i Kodit të Procedurës Civile për t'u kundërshtuar në gjykatë).

36. Për këto arsye, Kolegjet e Bashkuara konkludojnë se, me nenin 55 të ligjit për procedurat tatimore, ligjvënësi ka parashikuar organet kompetente, Drejtorinë e Apelimeve dhe Komisionin e Apelimeve, si shkallë hierarkike të apelimit administrativ. Dhe, në përfundim të tij, në zbatim të garancive kushtetuese, nëpërmjet këtij ligji, tatimpaguesit i është njohur e drejta e ushtrimit edhe të "apelimit tatimor" sipas kërkesave të ligjit procedural civil (neni 324 e vijues të Kodit të Procedurës

3 Neni 7 "Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor".
Neni 135, pika 1 "Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj".

Civile). Në këtë kuptim, gjykata nuk është shkallë e ankimit administrativ në hierarkinë e organeve të apelimit për tatimet dhe e drejta për të ushtruar mjetet gjyqësore në kundërshtim të akteve dhe veprimeve të administratës, megjithëse është e pakufizuar, shteti nëpërmjet rregullimeve ka parashikuar edhe kriteret për të ushtruar këtë të drejtë, që për rastet e çështjeve të kësaj natyre, janë përcaktuar në nenet 43, 55-59 të ligjit për procedurat tatimore, si dhe në ligje e tjera fiskale.

37. *Apelimi tatimor* kërkon respektimin e disa kushteve, por organet e shqyrtimit të tij duhet të respektojnë edhe kërkesat e nenit 143/3 të Kodit të Procedurave Administrative. Sipas kësaj dispozite, në ato raste kur kërkesa vlerësohet se nuk përmban të dhënat e domosdoshme që kërkon ligji apo ka mungesë në aktet shoqëruese, organi administrativ që shqyrton apelimin ka detyrimin ligjor që të *"ndihmojë ankuesin në përgatitjen e të gjithë dokumentacionit që kërkon procedura përkatëse"*.

38. Në rastin në shqyrtim, ankuesi ka ushtruar ankim administrativ me shkrim. Në dosjen gjyqësore nuk ka ndonjë akt të vërtetojë datën e ushtrimit të këtij ankimi.

38.1 Komisioni i Apelimit nuk ka shqyrtuar themelin e çështjes, duke parashtruar si shkaqe mungesën e dokumentacionit, si dhe mosvërtetimin e kryerjes së shkallës së parë të apelimit.

38.2 Në vështrim të situatës konkrete konstatohet se përllogaritja e detyrimit tatimor është bërë në datën 7.7.2004, por njoftim vlerësimi është nxjerrë me aktin nr.2797, prot., datë 10.10.2006. Qëndrim ky që bie ndesh me nenin 63 pika 3 të ligjit për procedurat tatimore dhe nenet 56/b e 59§1 të Kodit të Procedurave Administrative.

38.3 Po kështu, nëse pretendohet pavlefshmëria absolute e akteve, kërkim që nuk është i ndërvarur nga ndonjë afat parashkrimi, gjykata nuk mund të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, por, në zbatim të nenit 121 të Kodit të Procedurave Administrative dhe 331 të Kodit të Procedurës Civile, konstaton pavlefshmërinë për efekt të zgjidhjes së pasojave juridike që janë krijuar nga akti.

39. Mosmarrja në shqyrtim me arsyetimin se ankimi është paraqitur jashtë afatit apo se mungon akti që provon parapagimin në dokumentacionin që shoqëron ankimin, nuk do të thotë *apriori* se subjekti tatimor nuk ka plotësuar kërkesat ligjore. Pikërisht zbatimi nga organi administrativ i nenit 143 do të thotë jo thjesht marrje e masave për një proces të rregullt administrativ, por dhe një detyrim që i rikujtohet ankuesit që deri në seancën e shqyrtimit duhet të provojë këtë fakt, në të kundërt çështja nuk shqyrtohet.

40. Gjykata nuk mund të anashkalojë fakte të tilla që pas sjellin pasoja juridike, por duhet t'i analizojë ato dhe t'i vlerësojë në tërësinë e fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt gjykimi.

41. Siç evidentuam më lart, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave, asaj të shqyrtimit paraprak, në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit (neni 144 i Kodi të Procedurave Administrative) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit.

42. Sipas nenit 146 të Kodit të Procedurave Administrative, vendimi i organit që shqyrton apelimin administrativ është përfundimtar, por parë në korelacion me dispozitat e seksionit të VI të Kodit të Procedurave Administrative dhe me dispozitat e tjera që lidhen me këtë aspekt, rezulton se vendimmarrja e organit që shqyrton apelimin nuk është në çdo rast përfundimtare (si në rastet e inkompetencës, mungesës së juridiksionit, si dhe në rastet e mospranimit të ankimit për kalim afati apo mosplotësim dokumentesh).

43. Ligji lejon apeluesin që ta ankimojë vendimin e fazës së parë (vendim jo përfundimtar) në organin më të lartë hierarkik e më pas edhe në gjykatë.

43.1 Në asnjë dispozitë të legjislacionit fiskal nuk është parashikuar që vendimi i autoriteteve tatimore është i paankimueshëm në gjykatë. Është ligji vetë (Kodet e Procedurave Administrative dhe Civile), që ka parashikuar goditjen e aktit administrativ në rrugë gjyqësore.

44. Në vijim të logjikës juridike të përdorur më sipër, duke u kthyer konkretisht tek objekti i çështjes, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se e drejta e aksesit në gjykatë nuk mund t'i cenohet kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë apo gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore. Kështu që gjykata, para se të shprehet për juridiksionin, duhet të verifikojë pretendimet që kanë të bëjnë me këto mangësi apo gabime të administratës tatimore dhe t'i vlerësojë ato në tërësinë e fakteve dhe rrethanave të çështjes konkrete.

45. Në argumentim sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara, në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore, arrijnë në përfundimin se:

a) gjykata, kur shqyrton një çështje me objekt anulim njoftim vlerësimi tatimor, nuk

mund të mjaftohet vetëm me verifikimin e faktit të mosshqyrtimit të ankimit nga instancat kompetente administrative, për ta nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor. Ajo, referuar pretendimeve të paditësit, është e detyruar të verifikojë paraprakisht nëse ankimi administrativ është paraqitur në afat dhe nëse këtij ankimi i janë bashkëngjitur dokumentet shoqëruese sipas nenit 55 të ligjit për procedurat tatimore.

b) Nëse gjykatës i rezulton se ankimi administrativ është paraqitur jashtë afatit dhe/ose mungojnë dokumentet shoqëruese sipas nenit 55 të ligjit dhe ky është shkaku i mosshqyrtimit në themel të ankimit nga organi administrativ, gjykata vendos, konform neneve 36 e 59 të Kodit të Procedurës Civile, nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

c) Në të kundërt, nëse gjykata konstaton se ankimi administrativ, ndryshe nga ç'pretendon organi administrativ, është ushtruar në afat dhe ka qenë i shoqëruar nga dokumentet e nevojshme sipas kërkesave të ligjit, nuk mund të refuzojë shqyrtimin e çështjes, me arsyetimin se çështja nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ.

d) Gjykata, siç theksuam më sipër, e nxjerr çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor vetëm kur paditësi, për faj të tij, nuk e ka paraqitur ankimin administrativ në afat ose nuk ka kompletuar dokumentet shoqëruese sipas ligjit (megjithëse organi administrativ e ka vënë në dijeni për të metat e ankimimit). Nëse gjykatës i rezulton se jo për faj të paditësit (ankuesit) çështja nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ, atëherë në zbatim të nenit 42 të Kushtetutës, nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, që garantojnë një proces të rregullt ligjor, është e detyruar të shqyrtojë çështjen në themel, duke qenë ajo që ka juridiksionin për shqyrtimin e çështjes.

46. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se konstatimi i të metave që u vunë në dukje në marrjen e vendimit nga gjykata e shkallës parë për këtë çështje konkrete dhe përcaktimet unifikuese që u dhanë prej tyre në lidhje me interpretimin e kuptimit të dispozitave përkatëse të ligjit për procedurat tatimore, nga njëra anë do të ndihmojnë gjykatën që të rishqyrtojë çështjen mbi bazën e ligjit e të provave dhe nga ana tjetër do të shërbejnë edhe për gjykatat e tjera për të zbatuar në mënyrë të unifikuar këto dispozita gjatë zgjidhjes të problematikave të ngjashme, në të ardhmen.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 36 dhe 481 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë",

VENDOSËN:

1. Prishjen e vendimit nr.712, datë 3.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe dërgimin e akteve asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit, me tjetër trup gjykues.
2. Ky vendim për njësim të praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Thimjo Kondi (Kryesues), Artan Hoxha, Gani Dizdari, Nikoleta Kita, Agron Lamaj, Evjeni Sinoimeri, Ardian Dvorani, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Ardian Nuni.
Anëtarë kundër: Perikli Zaharia, Shpresa Beçaj, Irma Bala

MENDIMI I PAKICËS

Ne gjyqtarët e mbetur në pakicë çmojmë se vendimi nr.712, datë 3.7.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, i cili ka deklaruar mungesën e juridiksionit gjyqësor për gjykimin e mosmarrëveshjes, me objekt anulimin e aktit administrativ të detyrimit tatimor, në shumën 95.506 lekë, të datës 7.7.2004, është i bazuar në ligj. Kjo gjykatë ka deklaruar mungesën e juridiksionit duke arsyetuar se, "… nga ana e paditësit nuk është shteruar rruga hierarkike, pasi kërkesa e tij ankimore nuk është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve". Në vijim të arsyetimit kjo gjykatë parashtron se, "në rastin konkret ligji i veçantë (ligji për procedurat tatimore), i cili ka përparësi ndaj ligjit të përgjithshëm (neni 36 i Kodit të Procedurës Civile), parashikon mungesën e juridiksionit gjyqësor për gjykimin e kësaj çështjeje përderisa nuk

është respektuar procedura e parashikuar në këtë ligj".

Në vështrim të rrethanave të çështjes objekt shqyrtimi, e çmojmë me vend të analizojmë përmbajtjen dhe llojet e juridiksionit.

Sipas të drejtës procedurale civile, "rrethi i çështjeve, që në bazë të ligjit kanë të drejtë të zgjidhin organet e një sistemi, quhet juridiksion", dhe ndahet në dy degë kryesore, në atë administrativ dhe në atë gjyqësor.

Juridiksioni administrativ është e drejta e detyra e organeve të administratës shtetërore për të zgjidhur çështjet e mosmarrëveshjet, që sipas ligjit u janë lënë në kompetencë.

Juridiksioni gjyqësor është e drejta dhe detyra e gjykatave për shqyrtimin e çështjeve që u janë lënë atyre nga ligji.

Në bazë të ligjit të posaçëm nr.8560 "Për procedurat tatimore" në nenin 55 të tij, është parashikuar se "apelimi kundër akteve administrative tatimore bëhet në organet e apelimit tatimor, të cilat kanë shkallë hierarkike nga më i ulëti te më i larti". Në bazë të nenit 59 të këtij ligji, "Tatimpaguesi, pasi ka ndjekur të gjitha shkallët e ankimimit administrativ të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës".

Sikurse parashikohet në të drejtën e procedurës civile, "juridiksioni është një nga funksionet e shtetit, i cili bën dallimin ndërmjet pushteteve të ndara e të pavarura ndërmjet tyre, në funksionet ndërmjet organeve shtetërore dhe ndërmjet tyre e organeve të pushtetit gjyqësor".

Në Kodin e Procedurës Civile janë përcaktuar kufijtë ndërmjet dy juridiksioneve, si kushte i domosdoshme për respektimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e tyre dhe janë parashikuar edhe dispozitat për respektimin e këtij kufiri, siç bëhet fjalë në nenet 59 e 60 të Kodit të Procedurës Civile.

Në nenin 137/3 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet në parim se palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ. E njëjta gjë parashikohet edhe nga neni 59 i ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Në respektim të kërkesave të dispozitave ligjore të mësipërme, çmojmë se ezaurimi i rrugës së ankimit administrativ është një kusht i domosdoshëm për paraqitjen e padisë në gjykatë dhe ezaurimi i rrugës administrative bëhet vetëm në ato raste kur (organi administrativ) në rastin në shqyrtim Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Komisioni i Apelimit Tatimor pranë Ministrisë së Financave, është vendosur në kushte të tilla që të mund të shprehet për themelin e çështjes. Një nga elementet që duhet të respektohen në lidhje me këtë (që organi administrativ të mund të shprehet për themelin), është edhe afati i përcaktuar në ligj për paraqitjen e ankimit administrative tek organi i administratës shtetërore, i cili nuk është afat parashkrimi, pasi në nenin 64 të Kodit të Procedurave Administrative është parashikuar e drejta e palës që të kërkojë rivendosjen në afat pranë organit që zhvillon procedurën administrative.

Në kushtet kur Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nuk ka marrë në shqyrtim apelimi administrativ të paditësit, për shkak të kalimit të afatit ligjor për bërjen e apelimit, dhe kur Komisioni i Apelimit Tatimor në Ministrinë e Financave ka rrëzuar kërkesën e paditësit, ky i fundit duhej të kërkonte rivendosjen në afat pranë organit që ka zhvilluar procedurën administrative, gjë të cilën nuk rezulton ta ketë bërë. Mosveprimi i paditësit për të kërkuar të rivendoset në afatin e humbur pranë organit administrativ, paraqitet me pasoja në këtë rast, që lidhen me mosshqyrtimin në themel të çështjes nga asnjëra prej hallkave të ankimit administrativ, duke bërë që edhe gjykata të mos ketë mundësi të shprehet për themelin e çështjes, për shkak të mosshqyrtimit (ezaurimit) të rrugës së ankimit administrativ.

Përsa argumentuam më sipër, çmojmë se instituti i rivendosjes në afat lidhet me krijimin e mundësisë për organin administrativ që të shprehet për themelin e çështjes, e jo të mbyllë procedurën administrative duke vendosur mosshqyrtimin e ankimit si të paraqitur jashtë afatit. Për të garantuar të drejtën për t'u rivendosur në afatin e humbur, në rast refuzimi të kërkesës nga organi administrativ, neni 65 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon të drejtën e subjektit për të bërë ankim sipas rregullave të parashikuara në Kod.

Ligji prezumohet i njohur nga palët dhe në këtë kontekst paditësi duhet t'i parashtronte organit që zhvillonte procedurën administrative argumentet se kërkesa e tij ishte brenda afatit të përcaktuar në ligj, ose se afati është i humbur jo për fajin e tij. Vetëm atëherë kur organi administrativ do të refuzonte kërkesën e subjektit për rivendosjen e afatit të humbur, atëherë paditësi mund të atakonte vendimin e refuzimit në gjykatë që më pas të krijonte mundësinë për organin administrativ që të

shpallte për themelin e çështjes në respektim të kërkesave të neneve 55 dhe 59 të ligjit "Për procedurat tatimore" të nenit 137/3 të Kodit të Procedurave Administrative, të nenit 328/1 të Kodit të Procedurës Civile.

Kur gjykata shqyrton një çështje me objekt anulim njoftim vlerësimi tatimor, në respektim të dispozitave të kufijve ndërmjet dy juridiksioneve, çmojmë se ajo nuk është kompetente të verifikojë paraprakisht nëse ankimi administrativ është ushtruar në afat pranë organit administrativ. Këtë kompetencë mbi pretendimin e subjektit tatimor e ka në bazë të nenit 64 të Kodit të Procedurave Administrative organi që zhvillon procedurën administrative.

Në shqyrtimin e një çështjeje të tillë gjykata duhet të verifikojë nëse janë zbatuar kërkesat e neneve 55 dhe 59 të ligjit nr.8560 "Për procedurat tatimore", pasi në këtë ligj është parashikuar se apelimi kundër akteve administrative tatimore bëhet nga organet e apelimit tatimor të cilat kanë shkallë hierarkike nga më i ulëti tek më i larti. Në fjalinë e fundit të këtij neni parashikohet se "një çështje nuk mund të shqyrtohet në një nivel më të lartë apelimi pa u shqyrtuar në nivelin me të ulët. Ndërsa neni 69 i ligjit nr.8560 parashikon se "Tatimpaguesi pasi ka ndjekur të gjitha shkallët e ankimimit administrativ të parashikuar në këtë ligj, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës".

Ndryshe nga përcaktimet unifikuese dhënë me vendimin nr.3, datë 12.2.2008 të Kolegjeve të Bashkuara, pakica ka mendimin se: *Duke qenë se pala paditëse rezultoi të mos ketë shteruar rrugën e ankimit administrativ për shkak të paraqitjes së ankimit jashtë afatit të parashikuar në ligj, duke mos mundësuar që juridiksioni administrativ të shprehet për themelin e çështjes, për rrjedhojë duke qenë se nuk është ezauruar rruga e ankimit administrativ, çështja me të drejtë është nxjerrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë jashtë juridiksionit gjyqësor. Paditësi, vetëm pasi të ketë shteruar rrugën e ankimit administrativ (ku mund të kërkohet konform ligjit, rivendosja në afat), ka të drejtë t'i drejtohet gjykates me padi dhe konform nenit 31 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata të shqyrtojë pretendimin e paditësit në themel dhe të shpall atë të bazuar ose jo.*

Anëtarë: Shpresa Beçaj, Irma Bala.

MENDIM I PAKICËS

Unë, Perikli Zaharia, gjyqtar i mbetur në pakicë në çështjen me palë Thoma Nasi kundër dega e tatimeve Lushnjë, nuk pajtohem me atë pjesë të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që bën fjalë për detyrimin e gjykatës për të verifikuar paraprakisht nëse ankimi administrativ është paraqitur në afat.

Duke mbajtur parasysh pozicionin dhe rolin që sipas Kushtetutës së Shqipërisë ka gjykata, nuk mund të pranohet që kësaj të fundit t'i duhet të hetojë në çdo rast lidhur me afatin e ankimit administrativ, edhe kur paditësi, i cili ka barrën e provës, nuk ka parashtruar një kërkim të tillë.

Në nenin 137/3 të Kodit të Procedurave Administrative (KPrA), është parashikuar se, në parim, palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ. Nga ana tjetër, në nenin 59 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore" është parashikuar se tatimpaguesi, pasi ka ndjekur të gjitha shkallët e ankimit administrativ të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

Përmbajtja e këtyre dispozitave, siç pranohet, nënkupton kushtin që paraqitja e padisë në gjykatë në raste të tilla bëhet vetëm pasi është ezauruar ankimi administrativ ose me fjalë të tjera, referuar rastit në shqyrtim, pasi paditësi t'i jetë drejtuar Drejtorisë së Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Komisionit të Apelimit Tatimor pranë Ministrisë së Financave dhe këto organe ta kenë shqyrtuar në themel ankimin. Kështu, në kushtet kur nuk është ezauruar ankimi administrativ, gjykata nuk mund të vazhdojë shqyrtimin në themel të çështjes.

Në kushte të tilla mendoj se, vetëm nëse paditësi do të pretendonte mosrespektimin e një procesi të rregullt ligjor në trajtimin e ankimit administrativ të paraqitur sipas tij në afat, atëherë ai, në bazë të nenit 42 të Kushtetutës, legjitimohet që t'i drejtohet gjykatës. Në këtë rast, kësaj të fundit i duhet të verifikojë dhe kontrollojë ligjshmërinë e veprimeve të organeve administrative për mosshqyrtimin në themel të këtij ankimi.

Anëtar: Perikli Zaharia

KËRKESË
Nr.3867/1, datë 4.9.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për pasuritë që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Kukës-Shishtavec. Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

LISTA E PRONARËVE, PRONAT E TË CILËVE PREKEN SI REZULTAT I SHKARJEVE NË SEGMENTIN KUKËS-SHISHTAVEC

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip/m^2	çmimi	Thekër vlera/lekë	Shënime
1.	Zize Idriz Mustafa	3432	8	arë	5492	270	35 000	I konfirmuar nga ZVRPP
2.	Elmaz Avdil Serjani	3432	20	arë	520	270		I konfirmuar nga ZVRPP
3.	Bajram Elmaz Serjani	3432	21	arë	120	270		I konfirmuar nga ZVRPP
4.	Elmaz Avdyl Serjani	3432	23	arë	600	270		I konfirmuar nga ZVRPP
5.	Havzi Halim Serjani	3432	24	arë	720	270		I konfirmuar nga ZVRPP
	Shuma				7452	270	35 000	2 047 040

Vlera totale e shpronësimit është 2 047 040 (dy milionë e dyzet e shtatëmijë e dyzet) lekë.

KËRKESË
Nr.4988/1, datë 2.9.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për pasuritë që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Kardhiq-Delvinë. Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR KARDHIQ-DELVINË, KOMUNA CEPO, FSHATI CEPUN

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadast.	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë						Shënime
						Truall			Arë			
						m^2	çmimi	Vl(lekë)	m^2	Çmimi	Vl(Lekë)	
1.	Gafur	Shaqo	Ziaj	1369	50/13				15	445	6675	Konf nga ZVRPP
2.	Magrip	Mersin	Bizhga	1369	50/12				11	445	4895	Konf nga ZVRPP
3.	Haris	Mufit	Matushi	1369	50/11				11	445	4895	Konf nga ZVRPP
4.	Mehmet	Bajo	Bajo	1369	50/10				15	445	6675	Konf nga ZVRPP
5.	Arben	Mehmet	Bajo	1369	50/9				13	445	5785	Konf nga ZVRPP
6.	Vladimir	Mehmet	Bajo	1369	50/8				15	445	6675	Konf nga ZVRPP
7.	Haxhi	Iljaz	Ahmeti	1369	50/7				21	445	9345	Konf nga ZVRPP
8.	Dragot	Mersin	Bizhga	1369	50/6				21	445	9345	Konf nga ZVRPP
9.	Mehmet	Cerciz	Cako	1369	50/5				22	445	9790	Konf nga ZVRPP
10.	Paqësor	Namik	Mustafaraj	1369	50/4				27	445	12 015	Konf nga ZVRPP
12.	Iljaz	Sali	Shehu	1369	50/2				506	445	225 170	Konf nga ZVRPP
	Shuma (lekë)							0			301 265	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR KARDHIQ-DELVINË, KOMUNA CEPO, FSHATI PLESAT

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadast.	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë						Shënime
						Truall			Arë			
						m^2	çmimi	Vl(lekë)	m^2	çmimi	Vl.(lekë)	
1.	Sopot		Gerxolli	2989	44/3				90	252	22 680	Konf nga ZVRPP
2.	Cajup		Shehu	2989	44/6	234	1592	372528				Konf nga ZVRPP
3.	Rakip	Hodo	Mucaj	2989	48/15				150	252	37 800	Konf nga ZVRPP
4.	Gurga	Avdi	Decka	2989	48/14				326	252	82 152	Konf nga ZVRPP
5.	Maksut	Avdi	Decka	2989	48/13				136	252	34 272	Konf nga ZVRPP
6.	Limoz	Sali	Decka	2989	48/12				118	252	29 736	Konf nga ZVRPP
7.	Sali	Avdi	Decka	2989	48/11				91	252	22 932	Konf nga ZVRPP
9.	Feim	Tajar	Duro	2989	32/2				980	252	246 960	Konf nga ZVRPP
10.	Bajram	Tajar	Duro	2989	32/1				846	252	213 192	Konf nga ZVRPP
11.	Lesko	Emin	Hida	2989	31/1				449	252	113 148	Konf nga ZVRPP
12.	Izmet	Hetem	Shehu	2989	29/15				25	252	6 300	Konf nga ZVRPP
13.	Asim	Hetem	Shehu	2989	29/14				22	252	5 544	Konf nga ZVRPP
14.	Xhafer	Medi	Pogace	2989	29/13				36	252	9 072	Konf nga ZVRPP
15.	Fatmir	Mezin	Shehu	2989	29/12				50	252	12 600	Konf nga ZVRPP
16.	Dalip	Mezin	Shehu	2989	29/11				60	252	15 120	Konf nga ZVRPP
17.	Zaho	Mezin	Shehu	2989	29/10				61	252	15 372	Konf nga ZVRPP
18.	Brahim	Tolo	Shehu	2989	29/9				59	252	14 868	Konf nga ZVRPP
19.	Pelivan	Murat	Garxenaj	2989	29/8				58	252	14 616	Konf nga ZVRPP
20.	Lesko	Emin	Hida	2989	29/7				92	252	23 184	Konf nga ZVRPP
21.	Fizjon	Abedin	Zholi	2989	29/6				99	252	24 948	Konf nga ZVRPP
22.	Shaqo	Abedin	Zholi	2989	29/5				89	252	22 428	Konf nga ZVRPP
23.	Hasan	Braho	Hysa	2989	29/4				128	252	32 256	Konf nga ZVRPP
24.	Arshi	Xhipe	Batha	2989	29/3				84	252	21 168	Konf nga ZVRPP
25.	Hysen	Xhipe	Batha	2989	29/2				284	252	71 568	Konf nga ZVRPP
26.	Izmet	Hetem	Shehu	2989	29/1				654	252	164 808	Konf nga ZVRPP
	Shuma (lekë)							372 528			1 304 100	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR KARDHIQ-DELVINË, KOMUNA CEPO, FSHATI KODËR

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadast.	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë						Shënime
						Truall			Arë			
						m^2	çmimi	Vl.(lekë)	m^2	çmimi	Vl(lekë)	
1.	Halit	Mersin	Bizhga	2174	43/6				228	262	59 736	Konf nga ZVRPP
2.	Artur	Shamet	Burrnaci	2174	43/7				471	262	123 402	Konf nga ZVRPP
3.	Hysen	Veip	Shehu	2174	43/12				368	262	96 416	Konf nga ZVRPP
4.	Rushit	Rapo	Majko	2174	43/10				1390	262	364 180	Konf nga ZVRPP
5.	Fejzo	Seit	Logli	2174	42/6				1080	262	282 960	Konf nga ZVRPP
6.	Nustret	Xhemal	Novi	2174	42/8				579	262	151 698	Konf nga ZVRPP
7.	Shkëlqim	Nushet	Novi	2174	42/7				1020	262	267 240	Konf nga ZVRPP
8.	Bejo		Novi	2174	41/3				186	262	48 732	Konf nga ZVRPP
9.	Kudret	Xhevdet	Novi	2174	41/4				80	262	20 960	Konf nga ZVRPP
10.	Ajaz	Xhelo	Haska	2174	41/6				490	262	128 380	Konf nga ZVRPP
11.	Agron	Sinan	Mixha	2174	41/7				334	262	87 508	Konf nga ZVRPP
12.	Sadik	Etem	Hila	2174	41/8				447	262	117 114	Konf nga ZVRPP
13.	Nazif	Sinan	Mixha	2174	41/9				126	262	33 012	Konf nga ZVRPP
14.	Mahal	Dino	Muhameti	2174	40/6				333	262	87 246	Konf nga ZVRPP
15.	Astrit	Nevruz	Veizi	2174	40/5				524	262	137 288	Konf nga ZVRPP
16.	Sadik	Etem	Hila	2174	40/4				321	262	84 102	Konf nga ZVRPP
17.	Agron	Sinan	Mixha	2174	40/3				100	262	26 200	Konf nga ZVRPP
18.	Nazif	Sinan	Mixha	2174	40/2				105	262	27 510	Konf nga ZVRPP
19.	Agron	Sinan	Mixha	2174	40/1				326	262	85412	Konf nga ZVRPP

20.	Myrteza	Xhemal	Novi	2174	39/2				781	262	204 622	Konf nga ZVRPP
21.	Petrit	Myrteza	Novi	2174	39/7				556	262	145 672	Konf nga ZVRPP
22.	Reshat	Kalo	Sadiku	2174	39/4				1138	262	298 156	Konf nga ZVRPP
23.	Edmond	Reshat	Sadiku	2174	39/6				951	262	249 162	Konf nga ZVRPP
24.	Pelivan	Jaho	Haxhi	2174	38/10				310	262	81 220	Konf nga ZVRPP
25.	Harun	Nuro	Muhameti	2174	38/9				276	262	72 312	Konf nga ZVRPP
26.	Nuro	Kanan	Muhameti	2174	38/8				234	262	61 308	Konf nga ZVRPP
27.	Irfan	Anefi	Daci	2174	38/7				321	262	84 102	Konf nga ZVRPP
28.	Artur	Shamet	Burrnaci	2174	38/6				126	262	33 012	Konf nga ZVRPP
29.	Haziz		Veizi	2174	21/1				544	262	142 528	Konf nga ZVRPP
30.	Edmond	Reshat	Sadiku	2174	21/3				363	262	95 106	Konf nga ZVRPP
31.	Shkëlqim	Nushet	Novi	2174	21/4				664	262	173 968	Konf nga ZVRPP
32.	Muin	Zenel	Novi	2174	21/5				680	262	178 160	Konf nga ZVRPP
33.	Artur	Shamet	Burrnaci	2174	21/6				578	262	151 436	Konf nga ZVRPP
34.	Nustret	Xhemal	Novi	2174	21/7				1530	262	400 860	Konf nga ZVRPP
35.	Sadik	Etem	Hila	2174	21/8				324	262	84888	Konf nga ZVRPP
	Shuma (lekë)							0			4 685 608	

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR KARDHIQ-DELVINË, KOMUNA CEPO, FSHATI PRONGJI

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadast.	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë						Shënime
						Truall			Arë			
						m^2	çmimi	Vl.(lekë)	m^2	çmimi	Vl.(lekë)	
1.	Namik	Tafil	Kasi	3058	223				221	237	52 377	Konf nga ZVRPP
2.	Namik	Tafil	Kasi	3058	286/2				774	237	183 438	Konf nga ZVRPP
3.	Jaho	Ferik	Skreli	3058	286/3				1812	237	429 444	Konf nga ZVRPP
4.	Siri	Rexhep	Ruci	3058	289/1				1805	237	427 785	Konf nga ZVRPP
5.	Gurabi	Shamet	Liku	3058	293/11				175	237	41 475	Konf nga ZVRPP
6.	Shemo	Xhemal	Kadena	3058	293/10				859	237	203 583	Konf nga ZVRPP
7.	Pajtim	Xhemal	Kadena	3058	293/9				662	237	156 894	Konf nga ZVRPP
8.	Fredi	Vesel	Cafaj	3058	293/8				445	237	105 465	Konf nga ZVRPP
9.	Thanas	Dhimitër	Gjoka	3058	293/7				414	237	98 118	Konf nga ZVRPP
10.	Bejush		Recka	3058	293/6				609	237	144 333	Konf nga ZVRPP
11.	Jano	Lefter	Recka	3058	291/1				368	237	87 216	Konf nga ZVRPP
	Shuma (lekë)							0			1 930 128	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMMUNIKACIONIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR KARDHIQ-DELVINË, KOMUNA CEPO, FSHATI KARDHIQ

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadast.	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë						Shënime
						Truall			Arë			
						m^2	çmimi	Vl.(lekë)	m^2	çmimi	Vl.(lekë)	
1.	Dervish	Fuat	Shehu	2091	310/1				1919	223	427 937	Konf nga ZVRPP
2.	Qerim	Metkë	Shehu	2091	310/9				1016	223	226 568	Konf nga ZVRPP
3.	Adriatik	Arshi	Shehu	2091	310/8				596	223	132 908	Konf nga ZVRPP
4.	Arshi	Qazim	Shehu	2091	310/7				530	223	118 190	Konf nga ZVRPP
5.	Ligor	Hetem	Muho	2091	310/6				526	223	117 298	Konf nga ZVRPP
6.	Arshi	Qazim	Shehu	2091	311/2				246	223	54 858	Konf nga ZVRPP
7.	Adriatik	Arshi	Shehu	2091	311/3				283	223	63 109	Konf nga ZVRPP
8.	Zeqo	Hysni	Shahini	2091	311/4				521	223	116 183	Konf nga ZVRPP
9.	Gligor	Etem	Muho	2091	311/5				549	223	122 427	Konf nga ZVRPP
10.	Levend	Xhafo	Kroi	2091	322/1				678	223	151 194	Konf nga ZVRPP
11.	Zylfo	Beqir	Kroi	2091	322/2				417	223	92 991	Konf nga ZVRPP
12.	Daut	Muco	Kasi	2091	326/13				1188	223	264 924	Konf nga ZVRPP
13.	Kadri	Daut	Kasi	2091	326/12				2604	223	580 692	Konf nga ZVRPP
14.	Hakan	Shaban	Kida	2091	325/17				452	223	100 796	Konf nga ZVRPP
15.	Duro	Ali	Hina	2091	325/18				825	223	183 975	Konf nga ZVRPP
16.	Nuredin	Hajro	Mersini	2091	325/19				985	223	219 655	Konf nga ZVRPP
17.	Ahmet	Hakan	Kida	2091	325/20				302	223	67 346	Konf nga ZVRPP
18.	Sedat	Zilfo	Kroi	2091	328/5				827	223	184 421	Konf nga ZVRPP
19.	Qerim	Metkë	Shehu	2091	328/7				761	223	169 703	Konf nga ZVRPP
20.	Ahmet	Qerim	Shehu	2091	328/8				307	223	68 461	Konf nga ZVRPP
21.	Xhemal	Shaban	Serjani	2091	328/9				628	223	140 044	Konf nga ZVRPP
22.	Shaban	Besim	Serjani	2091	328/10				179	223	39 917	Konf nga ZVRPP

23.	Rakip	Xhavit	Burrnaci	2091	328/11				418	223	93 214	Konf nga ZVRPP
24.	Edmond	Rakip	Burrnaci	2091	328/12				755	223	168 365	Konf nga ZVRPP
25.	Evledi	Dasho	Shehu	2091	336/2				435	223	97 005	Konf nga ZVRPP
26.	Dervish	Fuat	Shehu	2091	336/1				717	223	159 891	Konf nga ZVRPP
	Shuma (lekë)										4 162 072	

Vlera totale e shpronësimit është 12 383 173 (dymbëdhjetë milionë e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.10.2008
Doli nga shtypi më 3.10.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2008

Çmimi 51 lekë